



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Raport përfundimtar mbi zbatimin e
Agjendës për Reforma Evropiane (ERA)
2016 - 2018

Dhjetor 2018
Prishtinë

Përmbajtja

HYRJE	3
I. Pasqyrë e përgjithshme	4
II. Pjesa narrative	6
2.1. Shtylla 1: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit	6
2.2. Shtylla II: Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve	12
2.3. Shtylla III: Punësimi dhe arsimi	30
Shtojcë: Pasqyrë e zbatimit të Planit të Veprimit	36

HYRJE

Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) është dokument i përbashkët i Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), respektivisht për zbatimin e reformave prioritare që kërkojnë vëmendjen e nivelit më të lartë politik. Fokusi, pra, është në reformat kyçe ekonomike, për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë. Në këtë drejtim, prioritetet e ERA-s shërbejnë si kornizë afatmesme, ndërsa plani i veprimit si kornizë afatshkurtër. Pas dakordimit të prioritetëve dhe hartimit të planit të veprimit (PV ERA), zbatimi i ERA-s është lansuar zyrtarisht nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Komisioneri i BE-së për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociata të Zgjerimit, më 11 nëntor 2016, në takimin e parë të *Dialogut të Nivelit të Lartë BE – Kosovë për Prioritetet Kyçe*, të mbajtur në Prishtinë. Ajo gjithashtu është miratuar nga Qeveria, më 9 nëntor 2016, dhe nga Kuvendi, më 15 shkurt 2017.

ERA përmban 22 prioritate dhe 135 veprime, të shpërndarë si në vijim:

- Shtylla1: *Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit*, me 9 prioritate dhe 25 veprime;
- Shtylla 2: *Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve*, me 7 prioritate dhe 78 veprime; dhe
- Shtylla 3: *Punësimi dhe arsimi*, e cila përmban 6 prioritate dhe 32 veprime.

Qeveria, si institucioni qendror nacional për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, ka zbatuar dokumentim dhe monitoruar zbatimin e tij, në bashkëpunim me Kuvendin, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera të pavarura përgjegjëse, sipas PV ERA. Kjo është bërë nën udhëheqjen e institucionit kryesor të mandatuar për koordinimin e procesit të integritimit evropian – Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE). Kjo është bërë edhe përmes strukturave shtetërore koordinuese për integrim evropian (Këshillit Ministror për Integrim Evropian [KMIE] dhe Komitetit Punues për Integrim Evropian [KPIE]), dhe punës së rregullt të Qeverisë. Ecuria e zbatimit të këtyre reformave është përcjellë edhe nga organet e përbashkëta BE – Kosovë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së.

Përveç këtyre, gjithashtu janë hartuar raporte të rregullta mbi zbatimin e ERA, ndërsa ky është *raporti përfundimtar* mbi zbatimin e saj. Ky raport përmbledh zhvillimet në zbatimin e planit të veprimit dhe përmbushjen e 22 prioritetëve gjatë periudhës *nga fillimi i nëntorit 2016 deri në fund të nëntorit 2018*. Raporti është hartuar nga MIE, bazuar në të dhënat e raportuara nga të gjitha institucionet zbatuese, sipas planit të veprimit. Ky raport është përditësim i raportit të është *miratuar formalisht nga Këshilli Ministror për Integrim Evropian (KMIE)*, në mbledhjen e mbajtur *më 8 nëntor 2018*.


Ky raport përmban dy kapituj. Kapitulli i parë jep një pasqyrë të përmbledhur, tekstuale dhe me diagrame, mbi zbatimin e ERA-s në dy nivele: (1) në përmbushjen e 22 prioritetëve; dhe (2) në zbatimin e planit të veprimit. Kapitulli i dytë përmban një përshkrim, në formë tekstuale, të zhvillimeve kryesore në zbatimin e të gjitha prioritetëve dhe veprimeve, përfshirë një pasqyrë të përmbledhur (në formë të kutive, pas secilit prioritet dhe nën-prioritet) të gjendjes në zbatimin e aktiviteteve përkatëse. Krejt në fund, shtojca jep një pasqyrë tabelore të zbatimit të planit të veprimit, duke specifikuar qartë veprimet që nuk kanë arritur të zbatohen dhe arsytet.

Të gjeturat tregojnë se deri më tani janë *zbatuar plotësisht 10 nga 22 prioritate*, ose 45.45% e tyre, ndërsa *12 prioritate*, ose 54.55% e tyre, janë në zbatim e sipër. Në anën tjetër, sa i përket planit të veprimit, deri më tani janë *zbatuar plotësisht 92 veprime*, ose 68.15% e tyre, ndërsa pjesa e mbetur prej 43 veprimeve, ose 31.85% e tyre, janë në zbatim e sipër.

I. Pasqyrë e përgjithshme

Sipas të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse, të paraqitura në diagramin në vijim, *niveli i zbatimit të prioriteteve gjatë periudhës nëntor 2016 – nëntor 2018 është 45.45%*, pasi që **10 nga 22 prioritete janë zbatuar plotësisht**, ndërsa 10 prej tyre (54.55%) janë në zbatim e sipër.

Diagrami 1. Zbatimi i ERA gjatë periudhës nëntor 2016 – nëntor 2018: niveli i zbatimit të prioriteteve



Më hollësisht, niveli i zbatimit për secilën shtyllë është si në vijim:

- Shtylla 1: nga 9 prioritete, 5 (55.56%) janë zbatuar plotësisht, ndërsa 4 prej tyre (44.44%) janë në zbatim e sipër;
- Shtylla 2: nga 7 prioritete, 2 (28.57%) janë zbatuar plotësisht, ndërsa 5 prej tyre (71.43%) janë zbatim e sipër; dhe
- Shtylla 3: 6 prioritete, 3 (50%) janë zbatuar plotësisht, ndërsa 3 prej tyre (50%) janë në zbatim e sipër.


Prioritetet e zbatuar plotësisht për secilën shtyllë janë si në vijim:

- Shtylla 1: *Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit:*
 - 1. 2. Ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlidhura, duke i harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët publik mund të kenë punësim apo emërim shtesë;
 - 1.6. Sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparente, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike; zbatimi i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit (AKK-DLK-3113/15);
 - 1.7. Zbatimi i vendimit të qeverisë të muajit mars 2016 mbi futjen e prokurimit të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të përmendura aty;
 - 1.8. Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara; dhe
 - 1.9. Vazhdimi i fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë nëpërmjet fuqizimit të kapacitetit të Prokurorisë Speciale që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë.
- Shtylla 2: *Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve:*
 - 2.3. Zbatimi në mënyrë sistematike i strategjisë dhe planit të veprimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale; dhe
 - 2.5. Zhvillimi i mëtejshëm i disa statistikave sektoriale, kyçe për politikë bërje në fushën e llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, statistikave të energjisë dhe atyre sociale.
- *Punësimi dhe arsimi*, e cila përmban 6 prioritete dhe 32 veprime:

- 3.1. Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë;
- 3.2. Përmirësimi i mundësive të punësimit: a) Përgatitja e planit të veprimit për trajtimin e papunësisë së të rinjve bazuar në vlerësimin e sfidave dhe duke u përqendruar në përmirësimin e rezultateve arsimore dhe mbështetjen e kalimit nga shkolla në punë; b) Ndërmarrja e masave për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës; dhe
- 3.3. Sigurimi i zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit, në veçanti nëpërmjet funksionalizimit të agjencisë për punësim dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që është në gjendje të iniciojë masat aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme.

Në anën tjetër, sipas të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse, të paraqitura në diagramin në vijim, *niveli i zbatimit të Planit të Veprimit gjatë periudhës nëntor 2016 – nëntor 2018 është 68.15%*, pasi që *92 nga 135 veprime* janë zbatuar plotësisht, ndërsa 43 prej tyre (31.85%) janë në zbatim e sipër.

Diagrami 2. Zbatimi i ERA gjatë periudhës nëntor 2016 – nëntor 2018: niveli i zbatimit të Planit të Veprimit



Më hollësisht, niveli i zbatimit për secilën shtyllë është si në vijim:

- Shtylla 1: nga 25 veprime, 20 (80%) janë zbatuar plotësisht, ndërsa 5 prej tyre (20%) janë në zbatim e sipër;
- Shtylla 2: nga 78 veprime, 52 (66.67%) janë zbatuar plotësisht, ndërsa 26 prej tyre (33.33%) janë në zbatim e sipër; dhe
- Shtylla 3: nga 32 veprime, 20 (62.5%) janë zbatuar plotësisht, ndërsa 12 prej tyre (37.5%) janë në zbatim e sipër.

II. Pjesa narrative

2.1. Shtylla 1: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit

1.1. Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit që e bën të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion

Ky prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime, prej të cilëve 1 është zbatuar plotësisht, ndërsa 1 është në realizim e sipër.

Veprimi i zbatuar:

- *Koncept-dokumenti mbi ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion*

Veprimi në zbatim e sipër:

- *Miratimi i legjislacionit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion*

Legjislacioni është propozuar në kuadër të Kodit Penal, i cili është miratuar nga Kuvendi më 23 nëntor 2018. Kjo çështje do të adresohet edhe me Projekt Kodin e Procedurës Penale, i cili është në fazën finale të hartimit.

1.2. Ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlidhura, duke i harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët publik mund të kenë punësim apo emërim shtesë

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 1 veprim:

- *Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike duhet të ndryshohet, në harmoni me rekomandimet e BE-së: a. duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publikë; b. duhet të theksohen qartë aktivitetet që zyrtarëve iu lejohet dhe iu ndalohet t'i kryejnë përderisa mbajnë postin; c. duhet të theksohen qartë aktivitetet që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit; d. duhet të theksohen qartë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit; e. duhet të theksohen qartë procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.*

Projektligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është miratuar nga Kuvendi i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 27 Prill 2018. Aktet nënligjore parashihet të hartohen dhe miratohen nga institucionet përgjegjëse zbatuese.

1.3. Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në financimin e partive politike:

- a) Realizimi i auditimeve të pavarura të financave të partive për vitet 2013-2015;
- b) Sigurimi i publikimit të raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj

Ky prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 4 veprime, prej të cilëve 3 janë zbatuar plotësisht, ndërsa 1 është në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- *Publikohen raportet financiare të partive politike dhe të ndërmerren veprim efikas për zbatim kundër atyre që nuk e përmbushin këtë*
- *Të ofrohet financim adekuat për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të partive politike*
- *Përzgjidhen auditorët e pavarur nëpërmjet thirrjes së hapur*

Veprimi në zbatim e sipër:

- *Ndryshohet ligji për financimin e partive politike për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe zbatim dhe sanksione efikase, në bazë të konsultimeve të gjera publike*

Për qëllim të financimit adekuat për përfundimin e procesit të auditimit për raportet financiare të subjekteve politike për vitin 2013-2016, nga Kuvendi është ndarë buxhet shtesë në vlerë prej 120,000 EUR, duke e ngritur kështu buxhetin nga 60,000 në 120,000 EUR. Ndërsa për auditim të raporteve financiare për vitin 2017 është ndarë buxheti në vlerë prej 30,000 EUR.

Më tej, më 19 tetor 2017, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nëpërmjet procedurës së rëndomtë, rotacionit ka përzgjedhur auditorët për auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike për vitet 2013 – 2016. Në dhjetor 2017 është përfunduar auditimi i financave të subjekteve politike, ku më pas, më 26 dhjetor 2017, KQZ ka publikuar raportet e audituara dhe raportet financiare të subjekteve politike për vitet 2013 – 2016. Ndërsa sa i përket procesit të auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike për vitin 2017, është në proces të tenderimit, përkundër tri dështimeve, për shkak të mos-aplikimit të operatorëve ekonomikë.

Sa i përket Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, ai është miratuar në Qeveri më 9 tetor 2018.

1.4. Realizimi i rishikimit të pavarur të mekanizmeve të llogaridhënies së të gjitha institucioneve të pavarura, agjencive dhe organeve rregullatore, përcjelljen e rekomandimeve të tyre dhe miratimin e masave legjislative që përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e llogaridhënies së këtyre institucioneve

Ky prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 4 veprime: 3 të zbatuar plotësisht dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- Kryhet një analizë cilësore e agjencive të pavarura dhe agjencive të pavarura rregullatore (analiza mbi rregulloren e marrëdhënies së punës, pagave, themelimin dhe organizimin e agjencive)
- Zotohet mbi zbatimin e rekomandimeve që dalin nga analiza cilësore
- Zhvillohet një koncept dokument për projektligjin mbi organizimin e administratës publike, shërbimin civil dhe pagat

Veprimi në zbatim e sipër:

- Miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike

Duke iu referuar dokumenteve strategjike për RAP siç janë: PVS MAP 2018 -2020, si dhe me Planin e Veprimit për Racionalizimin e Agjencive, Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për hartimin e Projektligjit për racionalizimin e valës së parë të agjencive.

Me 6 korrik 2018 Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin e Veprimit për Racionalizimin e Agjencive të Pavarura (vendimi nr. 21/55). Plani i Veprimit parasheh katër faza kryesore të procesit të racionalizimit. Ky aktivitet pavarësisht dinamikës së tij është zbatuar me kohë. Me 20 korrik 2018 janë përmbyllur konsultimet publike për "Draft koncept-dokumentit për valën e parë të racionalizimit dhe vendosjes së vijave të llogaridhënies për agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës". Pas takimeve konsultative përfshirë edhe shoqërinë civile dhe zyrtarëve të BE-së draft Koncept-Dokumenti është dërguar në Qeveri për Miratim më datën 21 shtator 2018. Pas shpërndarjes për opinione nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë dhe kompletimit të materialit, në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 9 tetor 2018 është miratuar Koncept Dokumenti në fjalë me vendim nr. 9/68.

MAP është duke punuar dhe synon që deri në fund të këtij viti të përfundohet hartimi e Projektligjit për racionalizimin e valës së parë të agjencive dhe të dërgohet për aprovim në Qeveri dhe në Kuvend siç është paraparë me dokumentet e lartë cekura.

1.5. Sigurimi që pakoja e planifikuar legjislative, që mbulon shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës shtetërore, përgatitet në mënyrë të koordinuar në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi në bazë të koncept dokumenteve të dakorduara në nivel qeveritar

Ky prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime: 1 i zbatuar plotësisht dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimi i zbatuar:

- Hartohen koncept dokumente për projektligjet mbi: shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike

Veprimi në zbatim e sipër:

- Të miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike

MAP ka zbatuar të gjitha përgjegjësitë sa i përket hartimit dhe miratimit të projektligjeve të pakos së RAP-it nga Qeveria. Tani mbetet të miratohen nga Kuvendi.

1.6. Sigurimi i një proces të përzgjedhjes që është transparent, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike; zbatimi i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit (AKK-DLK-3113/15)

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime:

- Ndryshimi i legjislacionit në fuqi për përzgjedhjen e institucioneve të pavarura për të siguruar procedura të fuqishme, transparente dhe të bazuara në merita të përzgjedhjes së kandidatëve:
 - Publikimi i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë
 - Përfshirja e shoqërisë civile në komisionet përzgjedhëse, në bazë të një përzgjedhje transparente dhe të hapur të përfaqësuesve të shoqërisë civile;
 - Fuqizimi dhe qartësimi i kriterëve minimale për kandidatët përmes përfshirjes së kriterëve të ngjashme me nenin 17 paragrafi 2 i ligjit mbi NP-të, për shembull, në ndryshimet në ligjin mbi konfliktin e interesit, duke i bërë kështu të aplikueshme në të gjitha agjencitë e pavarura dhe organet rregullative
- Qeveria zotohet të veprojë sipas rekomandimeve të lëshuara nga AKK më datë 15.02.2016 (AKK-DLK-3113/15) në lidhje me emërimet në 9 borde të NP-ve:
 - Formulari/deklarata nën betim ndryshohet për të pasqyruar ligjin, për të gjitha emërimet e ardhshme
 - ZKM-ja ndërmerr veprim sipas nenit 17.5 të ligjit (d.m.th 17.5 Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshttrim material – goftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.)
 - ZKM-ja ndërmerr veprime kundër zyrtarëve që kanë hartuar këtë formë/deklaratë që nuk është në përputhje me ligjin.
 - Sigurohet zbatimin e MM të nënshkruar ndërmjet Kuvendit, Qeverisë në njërën anë dhe Ambasadës së MB në Prishtinë në anën tjetër, për emërimet e anëtarëve të bordit të institucioneve të pavarura dhe agjencive

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.09.2017 sipas rekomandimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit të datës 22.02.2016 i ka shkarkuar nëntë (9) drejtorë të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore

Zyra e Kryeministrit/SKQ i është përmbajtur plotësisht Memorandumit të Mirëkuptimit të parë (I), të nënshkruar më 11 tetor 2017 në mes të Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ambasadorit të Britanisë së Madhe. Deri më tani është monitoruar procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit Drejtues të KEK-ut

dhe procesi i përzgjedhjeve të anëtarëve të Bordit Drejtues të Telekomit të Kosovës-TK, (të dy këto borde drejtues të emëruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës).

Me Memorandumin e Mirëkuptimit të parë (I) nga Partneri Implementues është monitoruar edhe procesi I përzgjedhjes së kandidatëve për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, propozimi i kandidatëve për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor është proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës me datën 13.03.2018.

Gjithashtu Zyra e Kryeministri/SKQ i është përmbajt plotësisht Memorandumit të Mirëkuptimit të dytë (II) i nënshkruar me datën 24 gusht 2018 në mesë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ambasadorit të Britanisë së Madhe.

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 844/2 të datës 07.05.2018 kandidatët e propozuar për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor nuk kanë marr votat e nevojshme për këto pozita, lidhur me këtë partneri zbatues e ka monitoruar procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, propozimi I kandidatëve për Drejtor dhe Zëvendës Drejtor është proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës me datën 11.10.2018.

Zyra Kryeministrit/SKQ nuk ka pasur mospajtime në qëndrime nga Partneri Implementues nga Ambasada Britanike në Kosovë, ka dhe do të ketë një bashkëpunim shumë të mirë. Lidhur me mospajtimet me rastin e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MTI, duke iu referuar shkresë së MAP nr. 266 të datës 24.01.2018, të gjitha veprimet dhe proceduar janë kryer në pajtim me legjislacionin në fuqi. E njëjta është edhe të Emërimi i Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT, shkresa e Ministrisë së Administratës Publike nr. 464 të datës 12.02.2018 janë kryer të gjitha proceduar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1.7. Zbatimi i vendimit e qeverisë të muajit mars 2016 mbi futjen e e-prokurimit të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të përmendura aty

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 7 veprime:

- Fillohet faza e dytë e pilot projektit të e-prokurimit
- Zbatohen ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike
- Trajtohen zyrtarët publik në nivel lokal
- Certifikohen zyrtarët publikë në nivel qendror
- Certifikohen zyrtarët publikë në nivel lokal
- Testohen modulet elektronike të prokurimit,
- Hartohen udhëzimet operative për e-prokurimin. Qeveria t'i ofrojë publikut të dhëna standarde të lexueshme nga makina në kohë reale të kontratave të prokurimit

Vendimi i Qeverisë, i marsit 2016, për prokurimin elektronik është duke u zbatuar plotësisht. Është përfunduar platforma elektronike dhe të gjitha Autoritetet kontraktuese e kanë të obligueshme t'i vendosin aktivitetet e prokurimit në platformë elektronike. Nga data 1 shtator 2016, sistemi i prokurimit elektronik është bërë i obligueshëm për të gjitha autoritetet kontraktuese në nivel qendror, për procedurat e prokurimit me vlera të mëdha dhe të mesme, ndërsa nga 1 Janar 2017, e-prokurimi është bërë i obligueshëm edhe për autoritetet kontraktuese në nivel lokal për procedurat e prokurimit me vlera të mesme dhe të mëdha.

Ndërsa nga 1 Janar 2018, sistemi i prokurimit elektronik është bërë obligativ për përdorim nga të gjitha autoritetet kontraktuese dhe për të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë mbi 1000 euro, apo rreth 98% e procedurave të prokurimit zhvillohen në tërësi në sistem të prokurimit elektronik deri në nënshkrim të kontratës. Aktualisht, të gjitha Autoritetet Kontraktuese (188) janë të regjistruara dhe përdorin platformën

e prokurimit elektronik. Janë rreth 6,000 operatorë ekonomik të regjistruar të cilët përdorin platformën në mënyrë aktive, ndërsa numri i të gjithë përdoruesve të regjistruar ka arritur në rreth 15,000.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në funksion të rritjes së përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik edhe nga ana e operatorëve ekonomik, nga gjysma e vitit 2018 ka nxjerr një vendim nëpërmjet të cilit nga data 5 Korrik 2018 për të gjitha prokurimet e centralizuara që zhvillohen nga AQP-ja, dorëzimi i ofertave do të lejohet vetëm në formë elektronike, ndërsa nga 1 Shtator 2018 për të gjitha prokurimet me vlerë të madhe të publikuara nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese – dorëzimi i ofertës bëhet vetëm në formë elektronike. Sipas planifikimeve që nga 1 Janar 2019 për të gjitha procedurat e prokurimit dhe për të gjitha vlerat dorëzimi i ofertave do të lejohet dhe të bëhet vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit të e-prokurimit.

Në kuadër të platformës elektronike, deri më tani janë 27,000 publikime nga 10,000 procedura të zhvilluara. Rreth 7,000 kanë përfunduar me nënshkrim kontrate, ose në mesatare 10 kontrata të nënshkruara për ditë pune. Të gjitha publikimet në prokurim elektronik janë publike dhe të qasshme për çdo pale të interesuar përfshirë kontratat e nënshkruara dhe disa dokumente mbi vlerësimin e ofertave të eliminuara dhe shpërblyera. Është reduktuar dukshëm kontakti fizik i zyrtareve të prokurimit me Operatorët Ekonomik potencial pjesëmarrës në procedura të prokurimit derisa monitorimi i të gjitha aktiviteteve/publikimeve bëhet në kohë reale.

Është zhvilluar legjislacioni i nevojshëm për zbatimin e ndryshimeve të Ligjit të Prokurimit ku hyjnë gjithsej 84 akte nën-ligjore në periudhën 2016-2018 përfshirë modulet dhe formularët e rinj. Në vazhdimësi anë mbajtur sesionet e trajnimeve dhe certifikimit. Në vitin 2016 numri i zyrtarëve të certifikuar ishte 391 për nivelin bazik ku ka qenë i përfshirë edhe moduli i e-prokurimit. Bazuar në raportin vjetor të KRPP-së për vitin 2017, në këtë vit janë certifikuar- trajnuar 256 zyrtarë të prokurimit nëpërmjet programit themelor profesional të trajnimit (përfshirë edhe për modulën e e-prokurimit) dhe 625 pjesëmarrës të trajnimit specifik për prokurim elektronik (nga operatorët ekonomik, OJQ, Auditor, hetues, zyrtar komunal). Ndërsa në vitin 2018, deri me këtë kohë, vetëm trajnimin për e-prokurim e kanë vijuar mbi 700 pjesëmarrës (auditorë, gjyqtarë, Drejtor të Drejtorive Komunale, Drejtor të Shkollave, etj.).

1.8. Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 1 veprim:

- *KGJK të realizojë një vlerësim të nevojave për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat Themelore Ekonomike. Vlerësimi do të përcaktojë kostot e buxhetit, si dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për reduktimin e rasteve të grumbulluara në Gjykatat Themelore Ekonomike*

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me mbështetje të projektit të USAID “Programi për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë”, në Gusht të 2017 ka përgatitur studimin e vlerësimit të kapaciteteve për trajtimin e lëndëve në Gjykatën Themelore, Departamentin për Çështje Ekonomike dhe Divizionin Fiskal në Departamentin për Çështje Administrative. Sipas kësaj analize është konkluduar se duhet të caktohen edhe dy (2) gjyqtarë shtesë në Divizionin Administrativ, për të trajtuar shkallën aktuale të lendeve të reja.

Në korrik të vitit 2017 janë dekretuar 52 gjyqtarë të rinj. 17 gjyqtarë të rinj janë caktuar nga KGJK-ja në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Në fund të tetorit 2018, 54 gjyqtarë kanë përfunduar trajnimin fillestar të mbajtur nga Akademia e Drejtësisë, ndërsa nga fillimi i nëntorit 2018 kanë filluar me zgjidhjen e lëndëve. Gjykata Themelore në Prishtinë ka rekrutuar katër (4) këshilltar profesional për të mbështetur Divizionin Fiskal. Po ashtu, në mbështetje të tyre janë edhe zyrtarë ligjorë. KGJK në bashkëpunim me Kryetaren e Gjykatës Themelore të Prishtinës, janë zotuar të caktojnë 2 gjyqtarë shtesë në Divizionin Fiskal (dy gjyqtar

ne Departamentin Administrativ). Ndërsa, Departamenti Ekonomik është fuqizuar me staf shtesë duke caktuar edhe një (1) gjyqtar. Aktualisht ne Departamentin Ekonomik kemi 5 gjyqtarë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është në fazën përfundimtare të rekrutimit të tridhjetë e shtatë (37) gjyqtarëve të rinj, dhe 112 bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në të gjitha gjykatat e Kosovës.

1.9. *Vazhdimi i fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë nëpërmjet fuqizimit të kapacitetit të Prokurorisë Speciale që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë*

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime:

- *Plotësim-ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimit të nivelit të lartë*
- *Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Prokurorisë Speciale për të kryer hetime financiare dhe për të konfiskuar pasuri*

Plotësim-ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit nr. 05/L-034 është miratuar nga Kuvendi me datën 30.03.2018. Dekreti nr. DL- 007-2018, Datë 17.04.2018, duke mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimit të nivelit të lartë.

Ndërsa sa i përket fuqizimit të kapaciteteve të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, Akademia e Drejtësisë ka mbajtur trajnime të specializuara. Gjatë vitit 2016 janë mbajtur trajnime të specializuara për 4 prokurorë për fushën e shpëlarjes së parave, ndërsa gjatë vitit 2017 janë trajnuar 15 prokurorë në fushën korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, shpëlarjes së parave, hetimin financiar dhe krimin e organizuar në përgjithësi, ndërsa në vitin 2018 janë trajnuar 2 prokurorë në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

2.2. Shtylla II: Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve

2.1. Promovimi i investimeve të huaja direkte

- a) Fuqizimi në mënyrë të konsiderueshme i kapaciteteve dhe përmirësimi i organizimit të portofolit të brendshëm të Agjencisë së Kosovës për Investime për t'i mundësuar përmirësimin e performancës për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve
- b) Krijimi i një program të shërbimit dhe kujdesit pasues për investitorët e mundshëm dhe mekanizmin e ankesës që ka kompetenca të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të tilla

Këto nën-prioritete nuk janë zbatuar plotësisht. Ato përmbajnë 5 veprime: 1 i zbatuar plotësisht dhe 4 në zbatim e sipër.

Veprimi i zbatuar:

- Shqyrtim i thellë i fushëveprimit të përgjegjësive të KIESA, aktiviteteve të saj dhe përshkrimeve të punës

Veprimet në zbatim e sipër:

- Ristrukturimi i KIESA për t'i mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar
- Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve
- Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit
- Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët

Ka përfunduar shqyrtimi i thellë i fushëveprimit të përgjegjësive të KIESA përmes një analize të detajuar krahasuese edhe me agjencitë e ngjashme në vendet e rajonit. Raporti me rekomandimet përkatëse është shfrytëzuar si bazë për përgatitjen e strukturës organizative të KIESA. Si rrjedhojë, është hartuar draft rregullorja mbi organizimin e brendshëm të MTI-së e cila pritet të miratohet në qeveri. Ndërsa sa i përket Themelimit të Bordit Këshillues në kuadër të KIESA-së është përgatitur vendimi i cili pritet të aprovohet në Qeveri.

Dy veprimet lidhur me zhvillimin e kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve për investitorët janë duke u zbatuar në mënyrë të kufizuar bazuar në mundësitë që KIESA ka me stafin aktual. Zbatimi i plotë i tyre mund të bëhet vetëm pas miratimit të strukturës së re organizative ku definohen edhe fushëveprimi dhe kompetencat e agjencisë.

2.2. Përmirësimi i mjedisit afarist

- a. Fokusimi në përmirësimin e treguesve të raportit "Të të bërit biznes" të Bankës Botërore

Ky nën-prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 5 veprime:

- Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik lehtëson reformën e të bërit biznes duke u fokusuar në rezultatet dhe arritjet në takimet e saj të rregullta
- Përmirësimi i renditjes për zgjidhjen e paafetësisë paguese nëpërmjet zbatimit efikas të kornizës ligjore për falimentimin
- Shkurtimi i procedurave, kohës dhe kostos për marrjen e lejeve ndërtimore, përfshirë nëpërmjet ndryshimit të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore si dhe për Leje ndërtimore në K2 2017
- Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion
- Numri biznesor i unifikuar

Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është zgjeruar me anëtarë të rinj dhe me mbështetjen e EBRD është duke u ri-dizajnuar funksionimi më i mirë i tij përfshirë edhe përmes mekanizmave mbështetës shtesë që do të rrisin efikasitetin e punës së Këshillit.

Në korrik të vitit 2016 është miratuar një ligj i ri për falimentimin i cili është harmonizuar pjesërisht me legjislacionin e BE-së përkatësisht Rregulloren 2015/848 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi procedurat e falimentimit. Ligji është i zbatueshëm për të gjitha shoqëritë tregtare. Pas miratimit të ligjit, janë definuar edhe procedurat për funksionimin e administratoreve falimentues dhe ka nisur zbatimi i ligjit nga gjykatat. Në funksion të kësaj, janë trajnuar 8 gjyqtarë dhe 9 bashkëpunëtorë profesional. Si rrjedhojë e forcimit të kornizës ligjore për falimentim, raporti i Të Bërit Biznes të Bankës Botërore, ka renditur Kosovën për këtë indikator nga vendi i 164 ku ishte në vitin 2016, në vendin e 50-të në raportin e vitit 2019. UA nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore është ndryshuar me UA nr. 06/2017 të miratuar me 23.05.2017.

Ndryshimet përfshijnë unifikimin e procedurave dhe standardizimin e kostove për marrjen e lejeve ndërtimore. MTI përkatësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve ka funksionalizuar regjistrimin online të bizneseve ku nga janari i këtij viti janë regjistruar 152 biznese. Databaza e regjistrimit online do të përditësohet dhe plotësohet vazhdimisht. Në maj të këtij viti ka hyrë në fuqi ligji i ndryshuar për Shoqëri Tregtare, ku një nga amendamentet mundëson krijimin e një numri të unifikuar të biznesit. MTI është duke punuar për definimin e aspekteve procedurale teknike për këtë përmes legjislacionit sekondar.

Si rezultat, janë përmirësuar disa tregues të Të Bërit Biznes. Në rankimin e përgjithshëm të 2018, Kosova kishte bërë përparim për 20 vende, nga vendi i 60 në të 40-tin. Edhe në vlerësimin e vitit 2019, ka vazhduar përparimi në disa indikatorë të rëndësishëm si marrja e lejeve ndërtimore, pagesa e tatimeve, tregtia ndërkufitare, pavarësisht se në rangimin e përgjithshëm ka pasur rënie për 4 pozita.

b. Harmonizoni rregullat me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar

Ky nën-prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime:

- *Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i hartuar;*
- *Konsultimet publike me Shoqërinë Civile dhe partnerët zhvillimor, të mbajtura;*
- *Ligji, i miratuar nga Kuvendi*

Projektligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim është hartuar në nëntor 2017. Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe partnerët zhvillimor për Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim janë përfunduar gjatë muajt nëntor 2017. Në muajin dhjetor 2017 është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës ndërsa në mars të 2018 është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

c. Reduktimi i barrës rregullative ndaj firmave, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licenca

Ky nën-prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime:

- *Ligji i ri për shoqëritë tregtare është konsultuar me shoqërinë civile dhe akterët relevantë dhe është miratuar*
- *Legjislacioni sekondar i ligjit për shoqëritë tregtare, i miratuar*
- *Regjistri Qendror Online për Licenca dhe Leje është përditësuar më tej, përfshirë tarifën dhe procedurat e kërkuara për marrjen e lejeve dhe ngarkimi i formularëve të aplikimit në bazën e të dhënave*

Ligji për Shoqëri Tregtare është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2018. Disa nga ndryshimet kryesore në ligj kanë të bëjnë me mbrojtjen e investitorëve minoritar, krijimin e numrit unik identifikues të biznesit, dhe (shiko raportin e nënkomitetit të ekonomisë). Sa i përket legjislacionit dytësor, Udhëzimi Administrativ për tarifën e shërbimeve si dhe procedurat për regjistrimin e bizneseve është miratuar me nënshkrimin nga Ministri me 19.10.2018. Gjithashtu është hartuar Udhëzimi Administrativ për numrin unik identifikues të bizneseve.

Ligji nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave parasheh themelimin, administrimin dhe funksionimin e Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave në nivelin qendror të Republikës së Kosovës. Pas hyrjes në fuqi të ligjit, Zyra Ligjore e Kryeministrit me mbështetje të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) ka identifikuar 480 leje dhe licenca. Për të gjitha lejet dhe licencat, është mbledhur informacion i hollësishëm përfshirë: aktet ligjore që rregullojnë lejen ose licencën, numrin e hapave që bizneset duhet të ndjekin, dokumentacioni i nevojshëm, pagesat dhe afatet që nevojiten për t'u pajisur me një leje apo licencë, etj. Të gjitha këto të dhëna janë vendosur në regjistrin elektronik të nivelit qendror për të gjitha lejet dhe licencat me mundësi qasje për publikun duke ndikuar pozitivisht edhe në rritjen e transparencës dhe lehtësim në sigurimin e informatave të hollësishme për bizneset dhe qytetarët për llojet e ndryshme të lejeve dhe licencave.

Zyra Ligjore, me përkrahjen e IFC-së dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera, gjatë periudhës nëntor 2017 - korrik 2018, ka bërë rishikimin dhe përditësimin e Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave. Për këtë qëllim, janë ndërmarrë këto masa:

- Rishikimi i listës së lejeve dhe licencave të identifikuar në nivel qendror nga procesi i gjendjes fillestare;
- Verifikimi i ndryshimeve në listën e lejeve dhe licencave të aplikuara gjatë viteve të fundit përfshirë edhe ato leje dhe licenca të reja që nuk janë pjesë e regjistrit të deritanishëm;
- Verifikimi i bazës ligjore dhe informacionit të marrë nga institucionet përkatëse për lejet dhe licencat ekzistuese si dhe për ato të reja;
- Finalizimi i listës së përditësuar të lejeve dhe licencave për çdo ministri/agjenci/ organizatë tjetër të pavarur me informacione të hollësishme si aktet ligjore dokumentacioni i nevojshëm, pagesat dhe afatet që nevojiten për t'u pajisur me një leje apo licencë, etj.;
- Përditësimi i këtyre ndryshimeve në regjistrin elektronik për lejet dhe licencat ekzistuese dhe vendosja e lejeve dhe licencave të reja;
- Publikimi elektronik i versionit të përditësuar të Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave.

Tani Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave përmban informacione për 456 leje dhe licenca për qytetarët dhe bizneset, të lëshuara nga 26 institucione qendrore në 21 fusha të aktivitetit ekonomik, ku përfshihen: leje, licenca, certifikata, autorizime, pëlqime, regjistrime dhe njohje. Në vazhdim, në bashkëpunim me IFC-në, do të bëjmë edhe një fushatë vetëdijësimi për institucionet, qytetarët dhe bizneset lidhur me ekzistimin e Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave dhe detyrimin e institucioneve, agjencive të pavarura dhe organeve të tjera për raportimin në Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit për lejet të reja dhe ndryshimet në leje dhe licenca ekzistuese, në pajtim me nenin 29 të Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

Në kuadër të reduktimit të barrës administrative, thjeshtimi i këtyre procedurave është proces i vazhdueshëm që sjell lehtësime dhe reforma në klimën e investimeve vendore dhe të jashtme. Në këtë kuptim, në kuadër të përditësimit të Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave, janë analizuar ligjet e viteve 2017 dhe 2018 të publikuara në Gazetën Zyrtare për të parë se a parashihet ndonjë procedurë administrative në ligjet e miratuara.

d. Prezantimi i ndryshimeve legislative për të përmirësuar menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Prioriteti përmban 3 veprime: 2 të zbatuar dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuar:

- Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar për të reformuar aspektet kryesore procedurale, institucionale dhe funksionale
- Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant, të mbajtura

Veprimi në zbatim e sipër:

- Ligji për inspektimet e përgjithshme, i miratuar

Në mars 2018, Qeveria ka miratuar Koncept Dokumentin për fushën e inspektimeve ku definohej mënyra e organizimit dhe menaxhimit të një sistemi të përgjithshëm të inspektimeve dhe është identifikuar legjislacioni aktual që rregullon llojet e ndryshme të inspektimeve. Ndërsa drafti i parë i ligjit për inspektimet nuk është hartuar ende. Si rrjedhojë, as dy veprimet pasuese për konsultimet publike me shoqërinë civile dhe miratimi i këtij ligji në parlament nuk janë zbatuar.

e. Përafrimi i legjislacionit, përmirësimi i kapaciteteve të Organeve të Konkurrencës dhe Ndhmës Shtetërore dhe sigurohet që fillojnë zbatimin e mandatit të tyre

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 4 veprime: 2 të zbatuar plotësisht dhe 2 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- Autoriteti i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatis një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun në Kosovë, me rekomandimet e duhura
- Siguroni pavarësinë operative dhe kapacitete të mjaftueshme për të përmirësuar efikasitetin e kontrollit të tij në ndihmën shtetërore

Veprimet në zbatim e sipër:

- Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për realizimin e hetimeve
- Përafrohet dhe ndryshohet ligji për ndihmë shtetërore dhe përafrohet legjislacioni sekondar

Sa i përket forcimit të procedurave, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) në vitin 2017 ka zhvilluar dhe miratuar Rregulloren nr. 01/2017 për Procedurat Hetimore e cila forcon aspektet hetimore të tregut në harmoni me ligjin e konkurrencës. Në funksion të zbatimit të plotë të disa neneve të ligjit të konkurrencës, Autoriteti në vitin 2017 ka miratuar këto udhëzime administrative:

- UA nr. 02/2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve horizontale;
- UA nr. 03/2017 për Përjashtimet Grupore të marrëveshjeve vertikale të ndërmarrësve;
- UA nr. 04/2017 për Përjashtimet Grupore të marrëveshjeve në sektorin e transportit;
- UA nr. 05/2017 për Përjashtimet Grupore në sektorin e sigurimeve; dhe
- UA nr. 06/2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjes për distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike.

Aktet e mësipërme përafrojnë më tutje legjislacionin tonë me aktet përkatëse të konkurrencës në Bashkimin Evropian. Për ngritjen e kapaciteteve të brendshme për realizimin e hetimeve, Autoriteti i Konkurrencës ka rekrutuar 4 inspektorë të tregut të cilët kanë filluar punën në Maj 2018 dhe pritet që deri në fund të vitit të rekrutojë edhe 3 pozita sipas buxhetit të miratuar për këtë vit.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka bërë hulumtimin dhe identifikimin e monopoleve në Republikën e Kosovës për 14 tregje. Raporti mbi gjendjen aktuale për monopole për 13 tregjet në Kosovë (tregu i

telekomunikacionit, transportit, lojërave të fatit, energjisë, mediave dhe produksioneve kinematografike, minierave, sigurimeve, prokurimit, mbeturinave, derivateve të naftës, sektorit bankar, furnizimit me ujë, produkteve farmaceutike, dhe pajisjeve fiskale) bashkë me rekomandimet përkatëse është ndarë me Qeverinë, Kuvendin dhe Komisionin Evropian. Autoriteti gjithashtu ka nxjerr informata mbi strukturën e tregut të ndërmarrjeve dhe pozitën e tyre dominuese të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Mënyra e përcaktimit të pozitës dominuese dhe monopoleve, është bërë duke u bazuar në proporcionin midis qarkullimit vjetor të ndërmarrjeve që operojnë në të njëjtin treg dhe qarkullimit vjetor të ndërmarrjes specifike.

Ligji nr. 05/L-100 për Ndhimën Shtetërore është miratuar më 23.12.2016, dhe është publikuar në gazetën zyrtare më 17 janar 2017. Ligji është përafuar pjesërisht me legjislacionin zbatues të neneve relevante të Traktatit përfshirë edhe Rregulloren e BE-së 2015/1589. Sa i përket legjislacionit sekondar, Departamenti për Ndhimë Shtetërore në shkurt të vitit 2018 ka nisur punën për hartimin e rregullores për procedurat e njoftimit të ndihmës shtetërore. Kjo rregullore ka kaluar të gjitha fazat e obligueshme legjislative përfshirë konsultimet e brendshme dhe publike dhe më datë 23 Tetor 2018 është miratuar në mbledhjen e Qeverisë. Rregullorja është përafuar me legjislacionin e BE përfshirë edhe me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 794/2004 me mbështetjen e ekspertëve të një projekti të BE-së. Ministria e Financave gjithashtu ka hartuar edhe draft-rregulloren për punën e Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

Me ligj është siguruar pavarësia operative duke bërë ndarjen e kompetencave midis Komisionit për ndihmë shtetërore si autoritet vendim-marrës dhe Departamentit për Ndhimën Shtetërore si organ që ofron asistencë profesionale dhe administrative për Komisionin është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, analizimin dhe mbikëqyrjen e të dhënave për ndihmë shtetërore. Departamenti për Ndhimën Shtetërore funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, dhe i nënshtrohet parimeve të shërbimit civil ndërsa Komisioni është organ i pavarur vendimmarrës anëtarët e të cilit zgjedhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes një procesi konkurrues.

Pas miratimit të ligjit për ndihmë shtetërore, në Shkurt të vitit 2017 është bërë marrëveshja në mes të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Ministrisë së Financave për transferimin e Zyrës për Ndhimën Shtetërore në Ministrinë e Financave ku është transferuar stafi një (1) i punësuar si dhe buxheti dhe asetet e zyrës për ndihmën shtetërore. Fillimisht Departamenti për Ndhimën Shtetërore ka pas dy (2) të punësuar, Drejtorin e Departamentit të Ndhimës Shtetërore dhe Udhëheqësin e Divizionit për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndhimës Shtetërore. Në nëntor 2017 është miratuar Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Financave, sipas të cilës Departamenti i Ndhimës Shtetërore ka dy divizione me gjithsejtë shtatë (7) të punësuar. Në fund të muajit Maj 2018, Ministria e Financave ka kompletuar Departamentin për Ndhimë Shtetërore me staf prej 5 punëtorë të rinj dhe 2 ekzistues. Stafi i rekrutuar i DNSH-së ka filluar punën më 21.05.2018.

Ndërsa Kuvendi ka nisur procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Ndhimës Shtetërore (KNSH) përmes konkursit të hapur në korrik të 2018. Anëtarët e KNSH-së duhet të emërohen nga Kuvendi i Kosovës, ku procedurat e përzgjedhjes sipas ligjit do të kryejnë 3 Komisionet Parlamentare të Kuvendit.

2.3. Zbatimi në mënyrë sistematike i strategjisë dhe planit të veprimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 5 veprime:

- Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut, duke u fokusuar në sektorët më të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale, krimeve financiare, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit (duke mbuluar aspektin gjinor)
- Rishikohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut
- Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimin në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit, të sigurohen të drejtat e punonjësve dhe të sigurohet konkurrencë e drejtë në fushën e biznesit
- Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet (me ndihmën e projektit IPA 2015)
- Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara

Gjatë vitit 2017 është bërë vlerësimi i rrezikut sektorial në sektorin e Lojërave të Fatit dhe në sektorin e ndërtimit dhe patundshmërive. Grupi punues, pasi ka bërë vlerësimin e rrezikut, i ka miratuar raportet përfundimtare, dhe i ka dorëzuar për miratim në Ministrinë e Financave. Në takimin e datës 24 Maj 2018, Bordi Mbikëqyrës i NJIF ka diskutuar ndërsa në qershor ka miratuar dy vlerësimet e rrezikut sektorial për sektorin e ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme (vendimi nr. 10/52), dhe për lojërat e fatit (vendimi nr. 10/52). Vendimi nr. 04/66 për OJQ-të është miratuar në shtator të 2018.

Me vendimin nr. 36 të Ministrisë së Financave të datës 23.10.2017, është krijuar Sekretariati i ri i Grupit të Përhershëm Qeveritar për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Gjatë periudhës dhjetor 2017 - shkurt 2018, Sekretariati ka bërë rishikimin e Planit Veprimit për Strategjinë e Luftimit të Ekonomisë Joformale për vitin 2018, me mbështetjen e Projektit të BE-së dhe bazuar në vlerësimin e Ekonomisë Joformale të hartuara gjatë vitit 2017. Gjatë prillit 2017 është mbajtur edhe një tryezë me temën bashkëpunimi strategjik ndër-institucional dhe me sektorin privat në parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit.

Që nga viti 2016, fokusi ka qenë në përmirësimin e zbatimit të pajtueshmërisë tatimore. Si rrjedhojë, është rritur shkalla e mbledhjes e tatimeve kufitare dhe atyre të brendshme në 2016. Dogana ka mbledhur 88 milionë Euro më shumë, ndërsa ATK 18 milionë Euro më shumë se gjatë vitit 2015. Janë pajisur me arka fiskale rreth 2,038 biznese të reja. Politika e riimbursimit të kuponëve fiskalë gjithashtu ka pasur efekte pozitive në fiskalizimin dhe formalizimin e aktivitetit biznesor. Në veçanti, është me rëndësi progresi i arritur në fiskalizimin e pompave të benzinës.

Edhe në vitin 2017 Administrata tatimore ka vazhduar performancën në rritjen e përmbushjes tatimore. Këtë vit, të hyrat nga ATK kanë shënuar rritje prej 7.2% krahasuar me vitin 2016. Këtë vit, me qëllim të përmirësimit të përmbushjes tatimore Administrata Tatimore ka arritur rezultatet si në vijim:

- Ka zbatuar të hyra në vlerë 388, 835,498.70 euro.
- Ka realizuar 36,139 vizita në total, të cilat kanë rezultuar me qarkullim shtesë në vlerë prej 181,322,835.40 euro,
- Ka lëshuar 6,279 gjoba mandatore në vlerën prej 1,624,600 euro,
- V lera e tatimit shtesë 16,199,498.13 euro,
- Kreditimi i TVSh-së 8,384,744.63 euro ulje të dhe zbritje e humbjes 11,050,947.49 euro.

Gjithashtu në këtë periudhë janë realizuar 1383 kontrole, me këto rezultate:

- 51,456,117.58 euro tatim shtesë (duke përfshirë ndëshkimet dhe interesin)
- kreditim i zbritur 13,159,818.54 euro dhe
- humbje e zbritur 38,412,272.79 euro.

Lidhur me mos pajisjen me arka fiskale gjatë periudhës raportuese janë realizuar 1,962 vizita tek bizneset. Numri i gjobave mandatore për mos pajisje me arka fiskale është 611 në vlerën 106,250 euro. Gjithashtu janë realizuar 3,083 vizita tek bizneset të cilat nuk lëshojnë kupon fiskal, janë lëshuar 2,518 gjoba në vlerën 577,500 euro.

Sa i përket periudhës janar - shtator 2018 Administrata Tatimore me qëllim të përmirësimit të përmbushjes tatimore ka arritur rezultatet si në vijim:

- Ka inkasuar të hyra në vlerë 346,590,015.16 euro.
- Ka realizuar 35,499.00 vizita, të cilat kanë rezultuar me qarkullim shtesë në vlerë prej 77,390,704.80 euro,
- Ka lëshuar 4,984.00 gjoba mandatore në vlerën prej 1,167,625.00 euro,
- vlera e tatimit shtesë vlerësohet te jete 5,383,612.10 euro;
- Ka pasur 2,728,105.90 euro ulje të kreditimit të TVSh-së dhe 4,232,916.57 euro zbritje të humbjes.

Janë realizuar 1,164.00 kontrole, me këto rezultate:

- 35,403,195.68 euro tatim shtesë (duke përfshirë ndëshkimet dhe interesin)
- Kreditim i zbritur 8,044,006.23 euro dhe
- Humbje e zbritur 23,773,922.21 euro.

Lidhur me vizitat për arka fiskale, janë realizuar 4,262.00 vizita ku janë shqiptuar 1,703.00 gjoba mandatore në vlerë prej 318,375.00 euro.

Në shkurt të vitit 2017, Kosova është anëtarësuar në organizatën Egmont Group të Njësive të Inteligjencës Financiare. Egmont Group është organizatë ndërkombëtare me 152 njësi të inteligjencës financiare të specializuara në luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Tani Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NJIF) ka qasje direkte në ueb-faqen Egmont Secure për shkëmbimin ndërkombëtar të informatave të inteligjencës financiare një element ky i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. Si rezultat i këtij anëtarësimi, është rritur numri i kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar gjatë vitit 2017 dhe 2018. Të dhënat tregojnë për një ngritje prej 90% të shkëmbimit dhe ndarjes spontane të informacionit me NJIF homologe.

Në planin e bashkëpunimit ndër-institucional të brendshëm, është bërë shkëmbimi i informative dhe bashkërendimi i veprimeve në mes NJIF dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit me qëllim të parandalimit, pengimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në vitin 2017, NJIF-K ka ndërmarrë 17 inspektive të pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca. Është mundur edhe qasja e NJIF në bazën e të dhënave të Doganës. NJIF dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës nën mbështetjen e Projektit të BE-së, kanë kryer Studimin e Fizibilitetit për qasje dhe shkëmbim të informative në mes të institucioneve qeveritare. NJIF ka pranuar 109 informata kthyesë nga institucionet tjera përfshirë Policinë, ATK dhe Doganën. Kjo do prit të ketë efekt pozitivë në ngritjen e cilësisë së analizave.

Si rezultat i punës së përbashkët ndër-institucionale, NJIF ka lëshuar tri udhëzime për ngrirje të përkohshme të transaksionit duke ngrirë përkohësisht mbi 1 milion Euro që dyshohet se janë përfituar në mënyrë të paligjshme.

Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës janë duke zbatuar projektin e përbashkët "iPROCEEDS" i cili ka si synim të ardhurat nga krimi kibernetikë duke mbuluar Evropën Jug-Lindore dhe Turqinë. Janë mbajtur mbi 13 aktivitete me institucionet tjera në kuadër të implementimit të këtij projekti. Institucionet kryesore pjesëmarrëse ishin: NJIF-K, PK, Prokuroria, BQK etj.

Bashkëpunimi ndër-institucional ka vazhduar edhe në vitin 2018. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, NJIF gjatë periudhës 01 Janar deri më 30 Shtator 2018, ka pranuar 119 kërkesa për informata nga agjencitë zbatuese të ligjit, ndërsa tek entitetet raportuese dhe agjencitë zbatuese të ligjit janë dërguar 276 kërkesa për informacion. Në kornizën e bashkëpunimit ndërkombëtar, NJIF ka pranuar 16 kërkesa për informata. NJIF në muajin shkurt të 2018, ka lëshuar një Urdhër për Ngrirje në shumë prej 229.990 euro, dhe 25.837 dollar amerikan për një kompani vendore.

Në kuadër të luftimit të ekonomisë jo-formale agjencitë ligj-zbatuese si Administrata Tatimore, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës kanë ndërmarr një varg veprimesh, hetime, kontrole, intervista me të dyshuar dhe shkëmbim informacioni përgjatë gjithë vitit 2017 që kanë rezultuar me inicim të 32 rasteve për shmangie tatimi dhe 21 raporte hetuese për prokurorinë. Aktivitete të ngjashme janë realizuar edhe në periudhën janar –shtator 2018 nga Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës duke rezultuar me 27 raporte finale hetuese për prokurorinë dhe 17 kallëzime penale.

Në mars 2017, Sekretariati ka publikuar raportin vjetor 2016 i cili mbulon aktivitetet dhe rezultatet e arritura në zbatimin e Strategjisë kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018. Raporti paraqet situatën dhe zhvillimet aktuale sa i përket performancës operative dhe rezultateve në parandalimin e ekonomisë joformale dhe kimit financiar duke u bazuar në objektivat dhe treguesit kyç të performancës të përcaktuara në Shtojcën 1 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018.

Sekretariati ka përgatitur edhe raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë së Luftimit të Ekonomisë Joformale 2017 dhe raportin gjashtë mujor për periudhën Janar-Qershor 2018, lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare. Raporti vjetor është publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave në tri gjuhët zyrtare.

2.4. Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve

- a) *Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth 'Aktit të Bizneseve të Vogla'*

Ky nën-prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime:

- *Struktura e koordinimit të ABV është themeluar, përfshirë pikat e kontaktit për secilën ministri*
- *KIESA fuqizon përpjekjet e gjera koordinuese të qeverisë për zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi i Aktit të Bizneseve të Vogla, përfshirë nëpërmjet takimeve të rregullta koordinuese*

Struktura koordinuese për Aktin e Biznesit të Vogël është themeluar me vendm të Kryeministrit nr. 02/129 me datë 27 Janar 2017. Janë krijuar pikat e kontaktit për secilën nga 12 dimensionet e Aktit të Biznesit të Vogël duke vendosur kështu strukturën koordinuese për këtë Akt. Në anën tjetër, KIESA ka forcuar rolin e saj koordinues sa i përket procesit të Aktit të Biznesit të Vogël. Në këtë kuptim, KIESA ka udhëhequr procesin e vlerësimit të Akti i Biznesit të Vogël përfshirë edhe dërgimin e komenteve shtesë tek OECD me datën 28.02.2017. Me rastin e publikimit të raportit nga OECD i cili planifikohet të bëhet në fund të këtij viti, KIESA si bartëse e procesit do të koordinojë punën me institucionet përgjegjëse përfshirë këtu edhe angazhimin shtesë në zbatimin e rekomandimeve.

b) *Miratimi i masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë*

Ky nën-prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 8 veprime:

- *Avancimi dhe përditësimi i rregullt i ueb-faqes, për tu përdorur si një platformë informuese online për bizneset, përfshirë këtu dhe infrastrukturën e cilësisë*
- *10 punëtori, të organizuara me qëllim të informimit të bizneseve sa i përket infrastrukturës së cilësisë dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni specifik vertikal, përfshirë këtu dhe promovimin e ueb-faqes si platformë informuese*
- *Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore në fushën e infrastrukturës së cilësisë, duke përfshirë mënyrën nëpërmjet trajnimit të stafit (organizimi i 30 moduleve të trajnimit) dhe organeve të vlerësimit të konformitetit*
- *1,500 standarde, të miratuara, me fokus në fushat e harmonizuara*
- *Laboratorët metrologjikë ekzistues, të furnizuar me pajisje*
- *Ligji mbi shërbime, i hartuar dhe konsultuar me shoqërinë civile dhe akterë të tjerë relevant*
- *Ligji mbi shërbime i miratuar (transpozimi i pjesshëm i Direktivës 123/EC mbi shërbime)*
- *Pika e vetme e kontaktit për shërbime, e themeluar dhe funksionale*

Ueb-faqja e MTI-së është ri-dizajnuar dhe populluar me të dhëna gjatë vitit 2017. Ueb-faqja është duke u përditësuar me të dhëna të reja në baza të rregullta. NË lidhje me punëtoritë për informim të bizneseve dhe palëve tjera të interesit me infrastrukturën e cilësisë dhe obligimet që dalin nga legjislacioni vertikal, në vitin 2017 janë mbajtur takime informuese me operatorët ekonomik për legjislacionin e ri në fushën e ashensorëve dhe për legjislacionin horizontal për lëvizjen e lirë të mallrave. Gjithashtu në tetor 2017, është mbajtur event i për shënimin e Ditës Botërore të Standardeve ku palët e interesit janë informuar për zhvillimet e fundit në adoptimin dhe zbatimin e standardeve. Këto aktivitete kanë vazhduar edhe në vitin 2018. Në shkurt 2018 është mbajtur një punëtori e përbashkët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Trupat për Vlerësimin e Konformitetit të autorizuar në lidhje me implementimin e legjislacionit për fushën e ashensorëve.

Në prill 2018 është mbajtur punëtori me përfaqësuesit e Asociacioni të Komunave, MMPH dhe MTI-së për të diskutuar për draftin final të Rregullores për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim. Në maj 2018 është mbajtur Konferenca për shënimin e Ditës Botërore të Metrologjisë dhe në qershor është mbajtur aktiviteti për shënimin e Ditës Botërore të Akreditimit. Gjithashtu në maj 2018 është mbajtur punëtori me përfaqësuesit e Operatorëve Ekonomik përgjegjës për tregtimin e lodrave në Kosovë, përfaqësues nga Dogana e Kosovës, Inspektorati i Tregut si dhe departamenti për mbrojtjen e konsumatorit. Tema e punëtorisë ishte 'Rëndësia e zbatimit të Rregullores nr. 02/2017 për Sigurinë e Lodrave' në kuadër të ngritjes së Infrastrukturës së Cilësisë në Republikën e Kosovës. Në qershor 2018, Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) në bashkëpunim me INDEP ka organizuar takimin ku është promovuar roli dhe rëndësia e standardeve në tryezën "Promovimi i standardeve për produkte vendore dhe implementimi i MSA-së".

Lidhur me ngritjen e kapaciteteve në fushën e infrastrukturës së cilësisë përmes trajnimit të vazhdueshëm të stafit, shumica e aktiviteteve kanë qenë të organizuara nga institucione të jashtme (kryesisht financuar dhe përkrahur nga BE) në kuadër të agjendës së integritimit evropian dhe forcimit të kapaciteteve të vendeve të rajonit. Në vitin 2017, divizioni për infrastrukturë të cilësisë ka marrë pjesë në 4 trajnime për tema si mekanizmat e monitorimit të tregut të pajisjeve elektrike dhe elektronike (shtator 2017), çështjet teknike të mbikëqyrjes së tregut për pajisjet elektrike/elektronike (gusht 2017), vlerësimi i ndikimit rregullativ në hartimin e strategjive dhe legjislacionit (tetor 2017), dhe sfidat dhe mundësitë në fushën e pajisjeve elektrike/elektronike (tetor-nëntor 2017). Gjatë vitit 2018 zyrtaret nga fushat e infrastrukturës së cilësisë ishin në një trajnim në Suedi (maj 2018), shkëmbyen përvojat me vendet tjera të rajonit në fushën e infrastrukturës së cilësisë, morën pjesë në forumin regional për mbikëqyrje të tregut lidhur me zbatimin e standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe morën pjesë në konferencën për metrologjinë ligjore (maj 2018).

Ndërsa njësitë tjera përgjegjëse për fusha të caktuara të infrastrukturës së cilësisë po ashtu kanë marr pjesë në aktivitete për ngritje të kapaciteteve. Zyrtarët e akreditimit kanë marrë pjesë në dy aktivitete të tilla në vitin 2017 për Rregulloren 305/2011 për vlerësimin e konformitetit (shkurt 2017) dhe për trupat e pakredituar (në Berlin, në tetor 2017). Gjithashtu, në qershor 2017 janë mbajtur tri trajnime dhe punëtori në fushën e mbikëqyrjes së tregut për Rregulloren e BE 305/2011, Direktivën 2014/30/BE dhe forumi regional për mbikëqyrje të tregut. Në prill dhe nëntor 2017 janë mbajtur punëtori rajonale për shkëmbimin e përvojave për tregun e produkteve të naftës dhe laboratorëve për testimin e produkteve të naftës. Në qershor 2017 është mbajtur një trajnim mbi zbatimin në praktikë të sistemit RAPEX për mbikëqyrjen e tregut në BE.

Në fushën e metrologjisë, në periudhën tetor-nëntor 2017, janë mbajtur 3 trajnime në vitin 2017 për fushën e presionit, matjes së vëllimit dhe transpozimit të direktivës për matjen e instrumenteve dhe Direktivës NAWI. Në vitin 2018, në fushën e metrologjisë është marr pjesë në 3 konferenca ndërkombëtare, 1 vizitë studimore në Kroaci, dhe një trajnim për kalibrim të pajisjeve të vëllimit.

Në periudhën midis tremujorit të fundit të 2016 dhe tremujorit të tretë të 2018, janë miratuar gjithsej 1,533 standarde. Në lidhje me furnizimin me pajisje të laboratorëve ekzistues të metrologjisë, ka përfunduar furnizimi me pajisje për 6 laboratorë (atë të presionit, metaleve të çmuara, forcës, matjen e temperaturës dhe lagështisë relative, si dhe laboratorin e kohës dhe frekuencës) si dhe janë blerë pajisjet për kalibrim të radarëve dhe alkometrave. Është mbajtur një trajnim 2-ditor për aftësimin e stafit për përdorimin e këtyre laboratorëve. Ndërsa këtë vit janë kompletuar me pajisje laboratorit i vëllimit dhe ai për matje elektrike është pajisur me mjete shtesë për kalibrim të radarëve.

Ligji për shërbime është miratuar dhe publikuar në gazetën zyrtare në prill të vitit 2017 pas konsultimeve me të gjitha palët e interesit. Ndërsa Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Funkcionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK) është miratuar në Qeveri me 23 Mars 2018 dhe hyn në fuqi një vit pas nënshkrimit. Duke e pasur parasysh se Pika e Vetme e Kontaktit është një ueb-portal i cili ndër-vepron me shume institucione tjera, MTI është në procedura të konsultimit të brendshëm me institucionet tjera lidhur me aranzhmanet rreth kësaj pike.

c) Prezantimi i programeve dhe instrumenteve të eksportit për ndihmuar që NMV-të të integrohen në zinxhirët global të vlerës, me qëllim të mbështetjes së ndërkombëtarizimit të tyre

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime: 2 të zbatuar plotësisht dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- *Bizneset, të mbështetura për të rritur konformitetin e produktit të tyre (certifikimi i produktit) dhe ndërkombëtarizimin e tyre*
- *Kosova merr pjesë në programin COSME për mbështetjen e NVM-ve në lehtësimin e qasjes në financa, përmirësimin e qasjes në tregje dhe rritjes së konkurrencës dhe kulturës ndërmarrëse*

Veprimet në zbatim e sipër:

- *Kosova i bashkohet Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve*

Sa i përket mbështetjes së bizneseve për të rritur konformitetin e produkteve të tyre përkatësisht certifikimi i produkteve, para pak kohe janë përzgjedhur 4 kompani që kanë plotësuar kushtet dhe tash pritet nënshkrimi i marrëveshjes për riimbursim.

MTI ka negociuar në emër të Qeverisë dhe ka nënshkruar marrëveshjen për pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME). Marrëveshja është ratifikuar nga Kuvendi dhe publikuar në Gazetën Zyrtare në gusht 2018. Po, ashtu muajin e kaluar, MTI përkatësisht Qeveria ka caktuar kontakt personin për këtë marrëveshje. Ndërsa në mars 2018 është mbajtur një punëtori me mbështetje të instrumentit të BE për asistencë teknike TAIEX ku është ofruar informacion mbi

programet që mbështeten prej programit, kriteret e kualifikimit dhe procedurat e aplikimit. Me Komisionin Evropian, është duke u shqyrtuar procedura lidhur me anëtarësimin në Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve.

d) *Miratimi i masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar me qëllim të rritjes së qasjes së NMV-ve në financa*

Ky nën-prioritet nuk është realizuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime: 1 i zbatuar plotësisht dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimi i zbatuar:

- *Futja në funksion e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK)*

Veprimi në zbatim e sipër:

- *Miratimi i ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare*

Gjatë vitit 2017 është themeluar grupi punues për hartimin e projekt ligjit për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare i cili ka hartuar draft ligjin. Në shkurt të vitit 2018 janë kryer konsultimet publike me palët e interesit ndërsa në prill 2018 Qeveria ka miratuar projektligjin. është proceduar për aprovim në Qeveri dhe është miratuar nga Qeveria. Aktualisht, Draft ligji në qershor 2018 ka kaluar leximin e parë dhe aktualisht është në procedurë shqyrtimi dhe miratimi në komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës.

Për të ndihmuar qasjen në financa për bizneset, është themeluar dhe funksionalizuar Fondi Kosovar për garantimin e Kredive. Fondi lëshon garancitë për shumën deri në 50% të kryegjësë së kredive për NMVM-të. Për mbulim të garancisë kualifikohen edhe kreditë afatgjatë investuese dhe kreditë për financim të kapitalit punues. Deri në shtator 2018, Fondi ka lëshuar 1,657 kredi për bizneset vendore me shumë prej 63.6 milionë euro. Sektorët kryesorë që janë mbështetur nga Fondi janë tregtia me shumicë dhe pakicë (43%), shërbimet (26%), prodhimi (18%), ndërtimtaria (7%), dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (7%).

2.5. *Zhvillimi i mëtejshëm i disa statistikave sektoriale, kyçe për politikë bërje në fushën e llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, statistikave të energjisë dhe atyre sociale*

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 5 veprime:

- *Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të llogarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë*
- *Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuar (vëllimit të prodhimit industrial dhe indeksit e çmimeve)*
- *Rezultatet nga statistikave të Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar*
- *Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, e kryer*
- *Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare*

Nga miratimi i PV ERA ASK ka bërë progres të konsiderueshëm lidhur me aktivitetet e parapara ne kuadër te PRE, si ne aspektin cilësor po ashtu edhe ne atë sasior. Në këtë kohë, ka nisur publikimi i llogarive kombëtare ne baza tremujore dhe shkurtimi i afateve kohore për BPV ne baza vjetore nga T+11 muaj që ishte ne vitin 2016 ne T+9 muaj, ne vitin 2018 që është standard i kërkuar nga Eurostat. Pra, tani Bruto Produkti Vendor vjetor publikohet ne afat prej T+9 muaj, ndërsa BPV tremujor në afat prej T+ 90 ditë (aq sa publikohet edhe në vendet e BE). Në vitin 2016, llogaritë qeveritare tremujore nuk janë publikuar fare. Tani, llogaritë Qeveritare vjetore dhe tremujore të Kosovës publikohen sipas planit dhe kalendarit. Publikimet bazohen në metodologjinë e ESA 2010.

Tabela 1. Progresi ne afate kohore ndër vite

Aktivitet / vitet	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
BPV vjetore	T+10 muaj	T+ më pak se 10 muaj	T+ 9 muaj
BPV tremujore	T+103 ditë	T+90 ditë	T+90 ditë
Llogaritë qeveritare vjetore	T+6 muaj	T+6 muaj	T+6 muaj
Llogaritë qeveritare tremujore	Nuk janë publikuar	T+ 105 ditë	T+90 ditë

Sa u përket disa statistikave afatshkurtra të biznesit, në periudhën 1 janar - 30 shtator 2018, ASK për herë të parë ka publikuar "Indeksi i Vëllimit të prodhimit Industrial" për tremujorin e parë 2018 me bazë vitin 2017 (2017=100) dhe për tremujorin e dytë të 2018 bazuar në planin dhe kalendarin e punës.

Në lidhje me të dhënat e anketës së fuqisë punëtore, nga viti në vit është bërë progres në përmirësimin e anketës së tregut të punës duke shkurtuar afatet kohore në baza vjetore dhe duke rritur cilësinë e të dhënave. Gjatë këtij intervali kohor gjegjësisht në vitin 2017, ASK-ja ka filluar me publikimin e të dhënave për tregun e punës edhe në baza tremujore me afat kohor publikimi më pak se T +90 ditë. Raporti i fundit është publikuar me kohë sipas planit vjetor dhe kalendarit për 2018. Me 17 Shtator 2018 është bërë publikimi i rezultateve për tremujorin e dytë të 2018.

Anketa e të ardhurave dhe kushteve të jetesës (SILC) është duke u zhvilluar për herë të parë në Kosovë. Përmes kësaj ankete matet niveli dhe kushtet e jetës në Kosovë. Në vitin 2014 është zhvilluar si pilot anketë duke planifikuar publikim të rezultateve në vitet 2017-2018. Për shkak të ndikimit të faktorëve të jashtëm (prolongimi i nënshkrimit të kontratës në mes të BB dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës) anketa nuk ka mundur të filloi së zbatuari në terren. Megjithatë gjatë këtij viti, anketa është kryer pasi që janë përgatitur pyetësorët dhe kanë përfunduar anketimi dhe mbledhja e të dhënave nga terreni në periudhën maj-korrik 2018. Raporti final pritet të publikohet në pjesën e dytë të 2019. Është paraparë që të dhënat të dërgohen në EUROSTAT në nëntor të 2019.

Në fushën e statistikave të energjisë, publikimi i të dhënave të bilancit të energjisë ka filluar në vitin 2009 pjesërisht në përputhje rregullore e energjisë se Eurostat-it, kurse që nga viti 2014, ky publikim është harmonizuar plotësisht me kërkesat e Eurostat-it. Nga viti 2010, ASK ka filluar me publikimin e statistikave të energjisë në baza tremujore. Afati i publikimit të këtyre të dhënave në baza tremujore është shkurtuar gradualisht nga ASK nga T+90 në vitin 2010 në T+45 në vitin 2018. Të dhënat për tremujorin e dytë 2018 janë publikuar me 15 gusht 2018, pra në afatin T+45 dite. Sa u përket statistikave për eficiencë të energjisë, ASK në vitin 2018 ka filluar me publikimin e tyre për periudhën referuese 2011-2016 në sektorët e amvisërisë dhe industrisë , ndërsa sektorët e shërbimeve dhe transportit janë planifikuar për vitin 2020. Publikimi statistikor për eficiencën e energjisë është bërë me 9 mars 2018 sipas planit vjetor dhe kalendarit 2018.

2.6. Përmirësimi i lidhjes rajonale

- a) Zbatimi i projekteve të investimeve publike individuale me prioritet, në veçanti duke miratuar raportin e rishikuar të zbatimit të klauzolës së investimeve, në bazë të "Listës prioritare të projekteve infrastrukturore"
- b) Zbatimi i të gjitha 'masave të buta' të mbetura të lidhjes, dhe reformat përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 19 veprime: 8 të zbatuar plotësisht dhe 11 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- Qeveria miratoi raportin e rishikuar mbi zbatim për klauzolën e investimeve
- Numri i marrëveshjeve financiare, i ratifikuar në Kuvend lidhur me projektet brenda Klauzolës së Investimeve
- Legjislacioni detyësor që rrjedh nga ai primar në sektorin e energjisë
- Çmimet e parregulluara të energjisë: Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së); Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së); Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së),
- Furnizuesit e rinj të energjisë elektrike, të krijuar
- Kodi i rrjetit të KOSTT-it, i harmonizuar me atë të ENTSO-E
- Hapja e tregut të transportit
- Rritja e efektivitetit të Procedurave të kalimit të kufirit

Veprimet në zbatim e sipër:

- Krijimi i tregut të përbashkët energjetik me Shqipërinë
- Krijimi i tregut të aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës)
- Zbatimi i Marrëveshjes ndërmjet KOSTT-EMS
- Zbatimi i strategjisë së reformës hekurudhore
- Krijimi i një sistemi konkurrues, të besueshëm dhe të sigurt sa i përket transportit
- Përmirësimi i sigurisë në rrugë. Synimi i uljes së aksidenteve për 20% krahasuar me vitin 2014
- Lehtësimi i tregtisë dhe transportit
- Vendosja e sistemit inteligjent të transportit (SIT) në Rrjetin Kryesor
- Krijimi i sistemit funksionues të mirëmbajtjes, duke siguruar që asnjë seksion të mos ketë gjendje të keqe/shumë të keqe
- Marrëveshjet efektive të kalimit kufitar
- Zbatimi i strategjisë për Menaxhimin e integruar të kufirit (MIK)

Zhvillimet kryesore kanë të bëjnë me hapjen e tregut energjetik dhe të transportit duke përafuar legjislacionin nacional dhe politikat me ato të BE-së, por gjithashtu duke investuar në projekte infrastrukturore që strategjikisht kontribuojnë në përmirësimin e ndërlidhjes rajonale.

Sa i përket zbatimit të projekteve të investimeve publike individuale me prioritet, duke miratuar raportin e rishikuar të zbatimit të klauzolës së investimeve, në bazë të "Listës prioritare të projekteve infrastrukturore", Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës në fillim të vitit 2015 iniciuan diskutimet me Fondin Monetar Ndërkombëtar për mundësinë e negociimit të një programi të ri me këtë institucion, ku përmes këtij programi do ndërmerreshin një sërë veprimesh për përkrahjen e reformave fiskale, financiare e strukturore të Qeverisë.

Pjesë e pandashme e diskutimeve me FMN ishte edhe nevoja për relaksim të Rregullës Fiskale që kufizon deficitin buxhetor, dhe rrjedhimisht edhe huamarrjen për financim të projekteve të investimeve publike. Ky ndryshim i rregullës fiskale i negociuar me FMN-në, tash i njohur si klauzola për investime, vlen vetëm për investime kapitale të cilat financohen nga IFN-të dhe donatorë të ndryshëm, në pajtim me kriteret e përcaktuara me ligj. Marrëveshja me FMN-në parasheh që të përgatitet raporti mbi zhvillimet rreth

klauzolës së investimeve. Klauzola e investimeve është parapa në kuadër të Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, nr. 04/L-194 dhe nr. 05/L-063.

Deri më tani Qeveria ka publikuar katër raporte për klauzolën e investimeve. Raporti i parë i Klauzolës së Investimeve i miratuar në muajin mars 2016 në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ka paraqitur bazën ligjore mbi mundësin e financimit të projekteve zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes huamarrjes shtetërore mbi deficitin buxhetor prej 2%, duke shpalosur kështu edhe përshkrimin e përgjithshëm të secilit projekt nga Lista e Projekteve e cila përmban në total tetë (8) projekte. Më tej, raportet tjera kanë vazhduar rifreskimin e listës: qershor 2016 (16 projekte), mars 2017 (19 projekte), dhe raporti i fundit për implementimin e Klauzolës për Investime është miratuar nga Qeveria në prill 2018.

Gjatë periudhës 2017-2018 janë ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës 7 marrëveshje kredie të cilat mbulojnë financimin e projekteve në vijim, që janë pjesë e Klauzolës për Investime:

1. Ligj Për Ratifikimin e Protokollit Financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për Hua për Zbatimin e Protokollit Financiar Ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe Natixis
2. Ligji nr. 05/L-157 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit të Projektit për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit të Ibër-Lepencit, Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim
3. Ligji nr. 06/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtar
4. Ligji nr. 06/L-018 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Financim Shtesë për Projektin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim
5. Ligji nr. 06/L-063 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë – Zahaq
6. Ligji nr. 06/L-098 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Autostradës Prishtinë – Pejë, Segmenti Kijevë – Zahaq
7. Ligji nr. 06/L-112 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.

Në kuadër të miratimit të legjislacionit sekondar të dalë nga pakoja e tretë e energjisë përgjatë periudhës 2017 dhe 2018 janë miratuar tetë (8) UA dhe një rregullore, pjesa më e madhe në fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Gjithashtu janë miratuar rregullat për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes, furnizuesit publik të energjisë elektrike dhe operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut, të cilat sigurojnë bazën ligjore për hapje të tregut dhe përmirësojnë kushtet për operacionalizim të tregut të përbashkët.

Gjatë periudhës së zbatimit të ERA 1 janë licencuar gjashtë furnizues të rinj të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës: "Kesco" J.S.C; "Hep-KS" SH.P.K; "Gsa energy" SH.P.K; "Sharrcem" SH.P.K; "Jaha Company" SH.P.K, dhe "Future energy trading and exchange dynamics" Sh.P.K. të cilat mundësojnë rritjen e zgjedhjeve nga ana e konsumatorit të fundit për blerjen e energjisë elektrike.

Harmonizimi i Kodit të rrjetit të KOSTT-it me atë të ENTSO-E, konsiderohet si veprim i përmbyllur. Duke u mbështetur në vendimet e dala nga Grupi i Lartë Permanent i Komunitetit të Energjisë, KOSTT fillimisht ka transpozuar dispozitat relevante nga Rregulla 2016/1388 dhe Rregulla 2016/631 në Kodin e Rrjetit të KOSTT, me ç'rast është mundësuar baza ligjore për lehtësim të transmisionit dhe qasja në rrjet të energjisë elektrike. Procesi për transpozimin e këtyre dy kodeve/direktivave nga ana e KOSTT ka përfunduar. Draft

versioni me transpozimet përkatëse të këtij Kodi është miratuar nga Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale (KQKO) dhe nga ZRrE-ja.

Në sektorin e transportit, Kosova ka hapur tregun hekurudhor për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore (Operatorët e Transportit Hekurudhor). Kështu Operatori privat "RAILTRANS" është licencuar dhe certifikuar nga Autoriteti Rregullativ Hekurudhor (ARH) dhe kjo kompani në vitin 2017 ka filluar me transportin hekurudhor të mallrave. Sa i përket plotësimit të kornizës ligjore, deri më tani janë miratuar një numër i konsiderueshëm i legjislacionit sekondarë (pesë (5) UA dhe shtatëmbëdhjetë (17) Rregullore), i cili avancoon hapjen e tregut të transportit. Një nga zhvillimet e fundit në këtë drejtim është edhe miratimi i Ligjit nr. 06/L-109 për ratifikimin e Traktatit të Transportit, nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2018.

Në mënyrë që të facilitohet tregtia dhe ofrimi i shërbimeve më të mira bizneseve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me ekspertin e angazhuar nga IFC/USAID ka përfunduar fazën e parë të takimeve me institucionet relevante, ku janë identifikuar të gjitha licencat, tarifrat dhe pagesat në fuqi. Lidhur me këtë është kërkuar arsyeshmëria e ekzistencës së licencës dhe pagesës përfshirë shumën e aplikuar; të tregohet se licencat a janë të bazuara në praktikën evropiane dhe në çfarë baze janë caktuar shumat. Në ndërkohë, është themeluar Udhëzuesi i Tregtisë Ndërkombëtare në Kosovë (ueb-faqe) i cili ka për qëllim t'u ofrojë informata eksportuesve dhe importuesve të mallrave në Kosovë për të kryer transaksionet tregtare si dhe për të kuptuar në thellësi procedurat ose proceset e veçanta lidhur me eksportin/importin e mallrave.

Për më tepër, me 28 qershor 2016 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit në mes agjencive kufitare (Dogana, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale), ku përmes këtij memorandumi parashihet shkëmbimi i të dhënave gjatë zhdoganimit të mallrave.

Dogana e Kosovës, gjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018 ka qenë e përqendruar në facilitim të tregtisë dhe thjeshtësim të procedurave doganore. Ky fakt më së miri dokumentohet në raportin e prezantuar nga Banka Botërore në 2019, ku indikatori "Tregtia Jashtë Kufijve" që ka të bëjë me Doganën, ka pas ngritje prej 8 pozitive, dhe në analizat prej 2013 deri më sot, pozita e vendit tonë në këtë indikator është ngritur prej pozitës 122 në 51, ngritje prej 70 vendeve, si rezultat i përkushtimit të përhershëm të Doganave të Kosovës për facilitimin e të bërit biznes.

Dogana e Kosovës ka ndërmarrë disa hapa drejt facilitimit të kontrollit të eksportit, duke fut në përdorim procedura të thjeshtësuara të eksportit. Bizneset tashmë përfitojnë nga ky thjeshtëzim me reduktim të kohës, kostos të eksportit, dhe janë eliminuar pengesat burokratike. Secili regjion doganor ka një njësi në gatishmëri që ofrojnë shërbime të eksportit 24 ore në ditë.

Doganat e Kosovës kanë vazhduar të rifreskojnë legjislacionin e saj që ka ndikim direkt në facilitim të tregtisë. Në vitin 2017 ka hy në fuqi UA nr. 38-2017 në dhënien e autorizimeve për marrjen e statusit të operatorit ekonomik. Kjo UA definon kriteret që duhet përmbajtur për marrjen e statusit të operatorit ekonomik.

Në këtë periudhë janë miratuar udhëzime që zbatojnë KDA si UA për ndryshimin dhe plotësimin e UA 2010 për banderola në pije alkoolike, UA te eksportueseve te autorizuar etj.

Gjithashtu është miratuar Udhëzimi Administrativ i brendshëm i doganës nr. 49/2018 i cili e ka ndryshuar dhe plotësuar UA nr. 69/2009 për autorizim për depot e mallrave akcizore që ndërlidhet me to edhe autorizimi për drejtues të një depoje të mallrave akcizore; me ç'rast është bërë një lehtësim te prodhuesit - eksportuesit dhe importuesit në lidhje me lëvizjen e mallrave akcizore me taksa të pezulluar deri në dalje në qarkullim të lirë.

Në janar të vitit 2018 me datë 18.01.2018, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Udhëzuesi i Brendshëm nr. 46/2018 lidhur me *Zbatimin E Kontrolleve Selektive në Operacionet Doganore*, që formalizon dhe inkurajon rritjen e efikasitetit dhe efektivitetin e përzgjedhjes duke u fokusuar në ngarkesat me risk më të lartë dhe krijon kushte për procedura më të shpejtuara të zhdoganimit për tregtinë legjitime aty ku risku është më i ulët, në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave – Konventa e Reviduar e KYOTOS, si dhe praktikat më të mira evropiane të përcaktuara në dokumentin e kaltër apo “CUSTOMS BLUEPRINT”.

Komiteti për Menaxhim të Riskut ka miratuar ndryshimet bazuar në rekomandimet e sektorit të Analizës së Riskut lidhur me qasjen e kanaleve, që ka rezultuar me selektivitet më kualitativ. Përderisa në vitin 2017 në kanal in e kuq (*kontroll i dokumentacionit dhe fizik*) janë kanalizuar 31% e dërgesave, pas ndërhyrjes ky kanal ka shënuar rënie në 20% të dërgesave. Në vitin 2017 gjithashtu ka qenë i ngarkuar edhe kontrolli e dokumentacionit nga përzgjedhja në kanal in e verdhë (*kontrolli i dokumenteve*) që vitin 2018 është ulur në 24% nga 51%. Pjesa e mbetur është kanalizuar në kanal in e gjelbër (*dërgesa nuk i nënshtrohet asnjë kontrolli*), që ka arritur vlerat nga 16% në 45% si dhe kanali i kaltër (*dërgesa mund ti nënshtrohet kontrollit pas importit*) që është ngritur nga 1% në vitin 2017, në 10% në vitin 2018.

Sa i përket modulit të e-pagesave që nga shtatori 2015 Dogana e Kosovës, ka filluar të aplikojnë pagesat elektronike (e-pagesa). Kjo procedurë mundëson konfirmimin elektronik të pagesave nga banka, dhe si rezultat procesi është përshpejtuar prej 30 minutave në 10 sekonda.

Dogana e Kosovës ka arritur që të kemi rreth 152 aplikacione të sistemit *online* në regjistrin e eksportuesve për vendet e EFTA, Sistemi REX. Është finalizuar Certifikata për AEO dhe Logo e AEO programit dhe këtë vit priten aplikacionet e para nga komuniteti i biznesit.

- 2.7. Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026
- Vendosja për modalitetet e pronësisë për Kosova B dhe për investimet e reja në gjenerimin e energjisë, dhe dekomisionimi i Kosovës A*
 - Miratimi i Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtëritshme*
 - Vlerësimi i modaliteteve më të mira për krijimin e mekanizmit për financimin e eficientës së energjisë dhe masat mjedisore në sektorin publik dhe atë të rezidencial, dhe nxitja e përdorimit të plotë të iniciativave ekzistuese siç është Programi Rajonal për Eficientë*

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 13 veprime: 10 të zbatuar plotësisht dhe 3 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- *Miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2016-2025*
- *Vendimi për modalitetet e pronësisë së Kosovës B*
- *Investimet e reja në gjenerimin e energjisë*
- *Afati i fundit për dekomisionimin e Kosovës A*
- *Raporti i dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për BRE*
- *Misioni i TAIEX për të vlerësuar modalitetet e mekanizmit të financimit për EE dhe mjedis*
- *Projektligji nr. 06/L-079 për Eficientë e Energjisë*
- *Miratimi i planit të veprimit 2016-2018 mbi eficientën e energjisë*
- *Miratimi i ligjit mbi performancën e energjisë në ndërtesa*
- *Rregullorja për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve për kondicionimin e ajrit*

Veprimet në zbatim e sipër:

- *Miratimi i Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtëritshme*
- *Rregullorja për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja të banimit, ndërtesat nën renovim dhe llojet e tjera të ndërtesave të banimit*
- *Rregullorja për certifikatën e performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ndërtesave të tjera*

Zhvillimet kryesore në kuadër të prioritetit në fjalë kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike duke përmirësuar legjislacionin, politikat si dhe investimet në burime të ripërtëritshme të energjisë, eficiencën e energjisë dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë drejtim, është shënuar progres me miratimin e Strategjisë së Energjisë 2017-2026 nga ana e Kuvendit me datë 26 janar 2018 e cila ka për objektive krijimin e kushteve për furnizim të besueshëm dhe të sigurt me energji duke i zhvilluar kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse, integrimin në tregun rajonal të energjisë, shfrytëzimin më eficient të energjisë dhe të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Për të siguruar zbatimin e Strategjisë, me 17 korrik 2018 me Vendimin nr. 01/57 është miratuar edhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë që mbulon periudhën kohore 2018-2020.

Me qëllim të adresimit të problemeve mjedisore nga teknologjia e vjetër e prodhimit të energjisë, me datë 20 tetor 2017 është marr vendimi (nga Kryeministri) mbi pronësinë e TC 'Kosova B', përmes të cilit TC "Kosova B" do të jetë në pronësi publike (së paku 51 % të aksioneve) për 10 vitet e ardhshme, me ç'rast mundësohen edhe investimet në këtë drejtim.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka pasur progres në investimet në gjenerim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Deri më tani, janë instaluar gjashtë (6) hidrocentrale me kapacitet total prej 30.5 MË (duke përfshirë HC Brezovica që filloi punën më 19 prill 2017, me kapacitet të instaluar prej 2.1 MË). Dy (2) panele fotovoltaike tashmë janë në operim me kapacitet total prej 0.6 kË; dhe në kuadër të burimit tjetër të energjisë- erës, një mulli ere është në punë me kapacitet 1.35 MË.

Në këtë drejtim gjatë vitit 2018 janë lëshuar tri autorizime përfundimtare për:

1. 16 projekte për hidrocentrale me kapacitet prej 61.9 MW;
2. Katër (4) projekte për energji solare me kapacitet prej 9.4 MW; dhe
3. Një (1) projekt për energji të erës me kapacitet prej 32.4 MW.

Sipas Strategjisë së Energjisë 2017-2026 të miratuar me 26 janar 2018, viti i dekomisionimit të TC Kosova A mbetet ai në të cilin do të hyjnë në funksion kapacitetet e reja prodhuese që parashihet të jetë viti 2023. Raporti i dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) është përgatitur në fillim të vitit 2017. Përmes këtij raporti ipen të dhënat e detajuara për shfrytëzimin e BRE-ve (energji fotovoltaike, biomasa solide, era, hidrocentralet ekzistuese) në Kosovë në mënyrë që të përmbushet caku prej 25% të energjisë të prodhuar nga BRE-të deri në vitin 2020, i cili shërben për definimin e masave për planifikim më të mirë në kuadër të Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtëritshme.

Në kuadër të krijimit të mekanizmit për financimin e eficiencës së energjisë dhe masat mjedisore, gjatë vitit 2017 janë zbatuar dy misione të TAIEK me ekspert nga Sllovenia të cilët kanë ofruar modalitete të ndryshme të financimit të masave në fjalë. Raporti dhe rekomandimet e dala nga dy misionet janë diskutuar mes akterëve relevant si MMPH, MZHE, MIE dhe MF. Në këtë drejtim, Projektligji për Eficiencën e Energjisë është miratuar nga Kuvendi më 11 nëntor 2018. Ky ligj krijon bazën ligjore për themelimin e Fondit për Eficiencë të Energjisë, përmes së cilit krijohen mekanizmat për financimin e eficiencës së energjisë. Për më tepër, me 2 gusht 2017 Qeveria ka miratuar Planin e Veprimit 2016-2018 mbi Eficiencën e Energjisë.

Sa i përket përmirësimit të eficiencës së energjisë në ndërtesa, me datë 01 dhjetor 2016, Ligji mbi performancën e energjisë në ndërtesa është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe dekretuar nga presidentit me 15 dhjetor 2016. Qëllimi i ligjit është të promovojë përmirësimin e performancës energjetike në ndërtesa, duke marrë parasysh kushtet e jashtme dhe lokale klimatike, si dhe kërkesat për klimën e brendshme dhe koston efektive. Ligji gjithashtu përcakton kërkesat për kornizën e përgjithshme për metodologjinë kombëtare për llogaritjen e performancës së integruar energjetike të ndërtesave dhe njësisë të tyre. Me qëllim të plotësimit të kornizës ligjore sekondare në këtë aspekt, me 27 shkurt 2018 ka hyrë në fuqi edhe Rregullorja për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve për kondicionimin e ajrit.

Marrë parasysh që vetëm tri nga veprimet e parapara në kuadër të këtij prioriteti deri më tani nuk kanë arritur të përmbushen, dhe faktin që pritet të përmbushen deri në fund të këtij viti, mund të themi që ky prioritet është adresuar në masë të konsiderueshme.

2.3. Shtylla III: Punësimi dhe arsimit

3.1. Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015- 2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime:

- *Strategjia Sektoriale është hartuar dhe konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve*
- *Strategjia Sektoriale dhe Plani i saj i Veprimit, të miratuara*
- *Buxheti për zbatimin e strategjisë është ndarë*

Strategjia Sektoriale 2018-2021 dhe Plani i saj i Veprimit 2018-2020, janë miratuar nga Qeveria më 28 shkurt 2018. Paraprakisht strategjia është konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve, ndërsa buxheti për zbatimin e saj është në linjë me planifikimet e parapara dhe zotimet e donatorëve. Jemi në proces të monitorimit për periudhën e parë gjashtëmujore, ku kemi përgatitur raportin fillestar mbi statusin e zbatimit të aktiviteteve.

3.2. Përmirësimi i mundësive të punësimit:

- Krijimi i një plani të veprimit për trajtimin papunësisë tek të rinjtë në bazë të një vlerësimi të sfidave dhe duke u fokusuar në përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe mbështetjen e kalimit nga shkolla në punë*
- Ndërmarrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës*

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 6 veprime:

- *Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është hartuar*
- *Draft Plani i veprimit është konsultuar me aktorët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve*
- *Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është miratuar*
- *Rritet asistenca e pranuar nga gratë nga shërbimi i punësimit*
- *Draft analiza e pengesave në punësimin e femrave është bërë në konsultime me akterët relevantë*
- *Përdorimi i analizës për zhvillimin e masave të duhura për përmirësimin e papunësisë së grave*

Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjve 2018-2020, është miratuar nga Qeveria më 04 janar 2018, i cili është konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve. Në bashkëpunim me institucionet e tjerat të përfshira ka nisur procesi i monitorimit ku është përgatitur raport fillestar mbi statusin e zbatimit të aktiviteteve.

Lidhur me rritjen e asistencës për gratë nga shërbimi i punësimit, është bërë përcaktimi i caqeve për rritjen e punësimit të gjinisë femërore. Gjatë vitit 2017 rreth **35.4%** apo në **3,181** raste të të ndërmjetësuarve përmes Zyrave të Punësimit për punësim të rregullt dhe masat aktive në tregun e punës kanë qenë gra. Përfshirja e grave në masat aktive të tregut të punës (subvencion në pagë, punë publike, vetëpunësim, praktikant, trajnim ne punë dhe aftësim profesional) vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 është **2,042** përfituese.

Sa i përket analizës se pengesave në punësimin e femrave, Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MSS), ka publikuar një hulumtim gjithëpërfshirës nacional, ku përfshihet edhe çështja e papunësisë së grave. Rezultatet e këtij hulumtimi do të përdoren nga MPMS për hartimin e politikave të punësimit dhe aftësimi profesional.

3.3. Sigurimi i zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit, në veçanti nëpërmjet funksionalizimit të agjencisë për punësim dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që është në gjendje të iniciojë masat aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme

Ky prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime:

- Realizimi i një vlerësim të nevojave të tregut të punës (përfshirë mbi AAP)
- Përzgjedhja e Drejtorit të Agjencisë së Punësimit dhe Bordit Këshillues është përfunduar dhe rregulloret e punës për Agjencinë e Punësimit janë miratuar
- Masat aktive të tregut të punës janë zbatuar nga Agjencia e Punësimit (thirrjet për aplikime janë lansuar, mbështetja financiare është dhënë sipas rezultateve të thirrjeve)

Përveç hulumtimit gjithëpërfshirës për pengesat në punësim në tregun e punës të zbatuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit, është bërë hulumtimi "Punësimi pas Aftësimi Profesional" lidhur me kandidatet që kanë përfunduar trajnimin në Qendrat e Aftësimi Profesional dhe gjendjes se sa prej tyre janë punësuar pas aftësimi.

Drejtori i Përgjithshëm i APRK është zgjedhur me 5 prill 2017. Janë emëruar anëtarët e Bordit Këshillëdhënës të Agjencisë së punësimit si dhe më 31 korrik 2018 është miratuar Rregullorja e Agjencisë së Punësimit.

Gjatë vitit 2017 Masat aktive të tregut të punës janë zbatuar nga Ministria e Punës dhe Agjencia e Punësimit. Thirrjet për aplikime janë lansuar, mbështetja financiare është dhënë sipas rezultateve të thirrjeve. Janë ndërmjetësuar në programet dhe projektet që mbështesin masat aktive të tregut të punës gjithsej: **9173** punëkërkuar, prej tyre **3181** janë femra, ndërsa **5992** janë meshkuj. Përfshirja të papunëve dhe punëkërkuarve në masat aktive të tregut të punës vetëm për periudhën janar-qershor 2018 në programet e subvencionit në pagë, në punë publike, vetëpunësim, praktikant, trajnim në punë dhe aftësim profesional kanë përfituar **1140** persona, prej tyre **371** femra **769** meshkuj.

3.4. Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit

Ky prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime: 1 i zbatuar plotësisht dhe 2 në zbatim e sipër.

Veprimi i zbatuar:

- Projektligji mbi profesionet e rregulluara në Kosovë, është miratuar

Veprimet në zbatim e sipër:

- Projektligji i rishikuar mbi arsimin e lartë, i miratuar
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 është miratuar nga Qeveria dhe është ndarë buxheti i nevojshëm për të siguruar zbatimin e tij

Në fund të vitit 2017 është formuar grupi punues për hartimin e Projektligjit të Arsimit të Lartë. Projektligji për arsimin e lartë është finalizuar dhe ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme. Pritet marrja e opinionëve të MF dhe MIE dhe pastaj dërgimi në Qeveri për aprovim.

Ndërsa Ligji nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara është miratuar nga Kuvendi në nëntor të vitit 2016. Në dhjetor të viti 2016, Qeveria ka miratuar Planin Strategjik të Arsimit 2017-2021. Plani është duke u zbatuar nga janari i vitit 2017 me një deficit buxhetor prej rreth 44.38 milionë Euro. Ende nuk është siguruar mjete për mbulimin e kësaj zbrazësie financiare.

3.5. Përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet:

a. Rritjes së vijueshmërisë së arsimit parashkollor

b. Realizimi i vlerësimit/vlerësimit të jashtëm dhe përsheptimi i zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë me tekstet e reja shkollore në arsimin para-universitar

Këto nën-prioritete nuk janë zbatuar plotësisht. Ato përmbajnë 4 veprime, nga të cilat 1 veprim është zbatuar plotësisht, ndërsa 3 veprime janë në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- Korniza e Kurrikulës Bërthamë e Arsimit Para-universitar (i vitit 2011 dhe 2012) është shqyrtuar dhe miratuar dhe rezultatet e të nxëniet për lëndët dhe klasat është janë zhvilluar në shkolla

Veprimet në zbatim e sipër:

- Numri i objekteve publike për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është rritur
- Kurrikulat bërthamë për arsimin parashkollor është zhvilluar dhe ka filluar faza e saj e pilotimit
- Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe silabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe miratuar me zbatimin të mëposhëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë këtë vit ka themeluar institucionin parashkollor në komunën e Gjilanit me kapacitet deri në 120 fëmijë. Gjithashtu, MASHT ka themeluar paralelja e ndarë në Mushtisht e institucionit parashkollor "Fluturat" në Suharekë. Ndërsa në kuadër të shkollave të reja fillore janë hapur 4 klasë parafillore. Në bashkëpunim me organizatën *Save the Children* në zonat rurale janë hapur 6 klasë parafillore. Vetëm për vitin 2018 janë licencuar rreth 20 institucione të reja parashkollore që nënkupton përfshirjen e rreth 1,200 fëmijëve.

Sa i përket ndërtimit të objekteve të reja publike për kujdesin ndaj fëmijëve, gjendja është si në vijim:

- 1 çerdhe në Prishtinë (ka filluar të ndërtohet në Lagjen Kalabria-me financim të KE, IPA 2014)
- 6 çerdhe në komunat Pejë, Skenderaj, Gjilan, Obiliq, Glogoc dhe në Prishtinë (Lagja Dardania) janë në procedura të angazhimit të punimit të projekt-dizajneve (financim i KE me IPA 2016)
- 2 çerdhe në komunat Kaçanik dhe Shtime, janë duke vazhduar punimet (financim i MASHT me IPA 2016)
- 1 çerdhe në Rahovec është në ndërtim (me buxhet të MASHT të vitit 2017)
- 1 çerdhe në Prizren është në procedurë të kontraktimit në MAP (me buxhet të MASHT të vitit 2017)
- 1 çerdhe në Prishtinë (është lidhur kontrata për ndërtim, financuar nga buxheti i MASHT i vitit 2018).
- 1 çerdhe në Klinë (është kryer projekt dizajni dhe pritet të vazhdojnë procedurat e kontraktimit, me buxhet të MASHT të vitit 2018).

Të dhënat tregojnë se në vitin 2016-2017, përfshirja në arsimin parashkollor (3-5 vjeç) ka qenë 33.9 %, ndërsa në atë para-fillor (5 vjeç) - 87.6 %. Kjo pjesëmarrje është rritur në vitin 2017-2018 në 36% për nivelin parashkollor përkatësisht 92.4% për nivelin para-fillor.

Sa i përket kurrikulës bërthamë për arsimin parashkollor, procesi për hartimin e kurrikulës bërthamë ka filluar qysh në vitin 2016. Gjatë vitit 2018 dokumenti ka kaluar procesin e diskutimit publik. Pas miratimit nga Ministri për të vazhduar procesin e finalizimit të dokumentit të kurrikulës bërthamë për edukim parashkollor, grupi punues pritet të finalizojë dokumentin dhe të hartojë udhëzuesit praktik për pilotim dhe trajnimin e edukatorëve. Të gjitha këto aktivitete i paraprijnë pilotimit të dokumentit të kurrikulës bërthamë për edukim parashkollor për fëmijët e moshës 0-5 vjet.

Ndërkaq, Korniza e Kurrikulës së Arsimit Para universitar 2011, si dhe Kurrikulat Bërthamë për tre nivelet e Arsimit formal (niveli I klasa 0,1-5, niveli II, klasat 6-9, niveli III, klasa 10-12) janë rishikuar. Gjatë vitit 2017 janë hartuar kurrikulat /programet lëndore për klasën përgatitore, klasat 1,6, dhe 10. Këto programe

së bashku me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, dhe tri kurrikulat bërthamë kanë filluar të zbatohen në të gjitha shkollat e Kosovës në vitin shkollor 2017/2018.

Draft-programet lëndore për klasat 2,7,11 të hartuara në vitin 2017 gjithashtu janë zbatuar në gjitha shkollat pilot të Kosovës gjatë vitit shkollor 2017/2018.

Në vitin 2018 MASHT ka rishikuar gjitha kurrikulat/programet lëndore për klasat 0,1,2,6,7,10,11. Programet lëndore për klasat 2, 7, 11 do të jenë pjesë e reformës dhe kanë filluar të zbatohen në të gjitha shkollat e Kosovës në vitin e ri shkollor 2018/2019. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar draft programet lëndore për klasat 3, 8, 12, të cilat gjatë vitit shkollor 2018/2019 kanë filluar të zbatohen në shkollat pilot. Përveç hartimit dhe rishikimit të programeve lëndore në gjuhën shqipe, turke, dhe boshnjake për klasat: 0,1,2,6,7,10,11, MASHT ka zhvilluar edhe draft programet për Gjuhën shqipe për nxënësit e komunitetit jo shqiptar për klasën 3,6,10, të cilat kanë filluar të zbatohen në ato shkolla ku kjo lëndë zgjidhet nga nxënësit. Është hartuar drafti final i Kornizës së Kurrikulës së Diasporës në bashkëpunim me përfaqësuesit e Institutit për Zhvillim të Arsimit të Shqipërisë. Është shpallur konkursi për tekste shkollore dhe materiale shkollore për klasat 0.1,6,10 dhe 2,7,11.

c. Krijimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe në shërbim të mësimdhënësve

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime: 2 të zbatuar plotësisht dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- *Mekanizmat për sigurimin e cilësisë të zhvilluara përmes emërimit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe krijimit të sistemit efikas për vlerësimin e performancës në shkolla*
- *Projektligji i rishikuar mbi inspektoratin e arsimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi dhe inspektorët kanë filluar aktivitetet e tyre, me inspektorë dhe kapacitete të mjaftueshme*

Veprimi në zbatim e sipër:

- *Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim është themeluar dhe është plotësisht funksionale*

Gjatë vitit 2017 janë emëruar koordinatorët e cilësisë në 24 komuna dhe afër 200 koordinatorë në nivel shkollor. Me ndihmën e një projekti të binjakëzimit, koordinatorët janë trajnuar. Në të tre nivelet përkatësisht nivel qendror të Ministrisë, nivel lokal të Drejtorive të arsimit dhe në nivel shkollor deri më tani janë emëruar mbi 90% e koordinatorëve të cilësisë sipas udhëzimit UA 24/2016. Në qershor është përzgjedhur koordinatori i cilësisë në MASHT.

Në prill të 2017 është miratuar Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e performancës dhe Udhëzuesi për Vlerësimin e Brendshëm të Mësimdhënësve, i cili ka hyrë në zbatim në shkollat që janë duke zbatuar kornizën e kurrikulës së re. Deri në nëntor 2017, shkollat e përfshira në program kanë zbatuar vlerësimin e brendshëm të performancës, për një fushë të cilësisë së shkollës. Inspektorati dhe trajnerët e programit kanë përkrahur shkollat në bazë të kërkesave të tyre lidhur me mbledhjen e të dhënave nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit dhe hartimin e raporteve.

Gjatë vitit 2018 janë planifikuar shkollat të cilat do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga inspektorët në të gjitha komunat e Kosovës. Secila komune do të ketë nga një shkollë e cila do të nënshtrohet vlerësimit të jashtëm. Qëllimi i vlerësimit është pasqyrimi i performancës së shkollës sipas Kornizës për Sigurimin e Cilësisë së Performancës.

Sipas Rregullores së re të MASHT, nuk do të ketë themelim të agjencinë, por do të fuqizohet divizioni për standarde vlerësim dhe monitorim duke ushtruar edhe kompetencat e parapara për agjencinë. Projektligji për Inspektoratin e Arsimit është miratuar nga Qeveria më 27.12.2017. Në korrik të 2018, ligji i inspektoratit të arsimit është miratuar nga Kuvendi.

d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë

Ky nën-prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 2 veprime: 1 i zbatuar plotësisht dhe 1 në zbatim e sipër.

Veprimi i zbatuar:

- *Krijimi dhe funksionalizimi i Këshillave Industriale*

Veprimi në zbatim e sipër:

- *Shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit*

Të gjithë Trupat Këshillëdhënës (Bordet industriale) i kanë draftuar dhe i kanë nënshkruar rregulloret e punës për funksionimin e tyre. Universiteti i Prishtinës, në 10 njësi akademike, ka themeluar 10 Trupa Këshillëdhënës. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka themeluar 1 Trup Këshillëdhënës. Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka themeluar 2 Trupa Këshillëdhënës. Universiteti "Haxhi Zeka" ka themeluar 3 trupa këshillëdhënës. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" është në fazën e hartimit të rregullores për trupat këshillëdhënës, ndërsa Universiteti i Gjilanit, e ka miratuar rregulloren.

Sa i përket shqyrtimit të programeve dhe politikave të regjistrimit, Agjencia e Akreditimit të Kosovës në vitin 2017 ka suspenduar rreth 150 programe të cilat nuk kane plotësuar kriteret minimale për sigurim të cilësisë.

Në muajin mars 2018 është miratuar Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Sipas këtij Udhëzimi, Këshilli Shtetëror i Cilësisë përbëhet prej 9 anëtarësh. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar zgjedhjen e anëtarëve të KSHC-së.

Ndërsa në muajin Prill 2018 është krijuar Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në përbërje prej 9 anëtarësh, nga të cilët 6 vendor dhe 3 ndërkombëtar. Prej tyre, 4 anëtarë të KSHC-së janë të gjinisë femërore.

Në muajin korrik KSHC ka mbajtur dy takime (mbledhja e 57 dhe 58), ku janë shqyrtuar kërkesat e IAL. Nga Tetor i vitit 2018, ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ për Akreditim i plotësuar. Gjithashtu me vendim të Ministrit të Arsimit, është themeluar Komisioni për draftimin e koncept dokumentit për Agjencinë e Akreditimit. Agjencia e Akreditimit është në proces të themelimit të Komisionit të Ankesave, sipas UA për Akreditim nr. 15/2018. AKA është në procese të rivlerësimit nga Asociacioni Evropian për Vlerësimin e Cilësisë (ENQA).

e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë IAL-të mbi rëndësinë e kurrikulave mësimore, identifikimi i mangësive në shkathhtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvujtje në punë praktike për studentët

Ky nën-prioritet është zbatuar plotësisht. Ai përmban 3 veprime:

- *Projekt propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në universitete që këshillojnë IAL-të, është prezantuar*
- *Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitete që këshillojnë IAL-të shkon në konsultime publike*
- *Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitetet që këshillojnë IAL-të është miratuar dhe fillon zbatimin*

Të gjitha Trupa Këshillëdhënës (Bordet industriale) i kanë draftuar dhe i kanë nënshkruar rregulloret e punës për funksionimin e tyre. Në universitete publike në vend janë krijuar gjithsej 16 trupa këshillëdhënës nga të cilat dhjetë vetëm në Universitetin e Prishtinës. Për më shumë detaje, shih veprimin paraprak.

3.6. Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë

Ky prioritet nuk është zbatuar plotësisht. Ai përmban 5 veprime: 1 i zbatuar plotësisht dhe 4 në zbatim e sipër.

Veprimet e zbatuara:

- *Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (së bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë*

Veprimi në zbatim e sipër:

- *Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësisimit profesional përmes harmonizimit të AAP me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës*
- *Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit*
- *Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së*
- *Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore*

Vlerësimi i nevojave të tregut të punës (referuar pikës 3.3) shfrytëzohet në analizat dhe hartimin e politikave të Ministrisë së Arsimit. Edhe konkurset për pranimin e nxënësve në shkollat profesionale këtë vit janë bazuar në kërkesat e tregut të rajonit përkatës. Bazuar në këtë, në disa raste, drejtoritë e arsimit kanë kërkuar hapje të profileve të reja.

Me qëllim të harmonizimit të profileve profesionale në tregun e punës, me mbështetjen e GIZ, ka përfunduar hulumtimi në 68 shkolla profesionale, 8 qendra të aftësisimit të MPMS, dhe 4 ofrues privat të AAP. Është prezantuar raporti mbi të gjeturat e hulumtimit. Ky raport shqyrton aspektet si organizimi dhe menaxhimi, rekrutimi dhe zhvillimi i stafit, cilësinë, përmbajtjen dhe atraktivitetin e programeve, gjendjen e objekteve dhe pajisjeve si dhe financimin.. Ka filluar projekti rajonal, mësimi i bazuar në vend të punës në mes të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës si dhe projekti i njohjes paraprake, përkrahur nga ETF.

Është hartuar drafti i parë i Kornizës së Kurrikulës së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional. Dokumenti i është nënshtruar të gjitha procedurave të diskutimit publik, ku janë marrë edhe inputet nga akterët relevant. Aktualisht, në dokument janë duke u adresuar komentet e palëve të interesit. Ndërsa Kurrikulat për 80 profile, për klasën e 10- të, do të hartohen në bazë të Kornizës së Kurrikules të AAP. Janë identifikuar standardet për profesione prioritete të cilat do plotësohen apo hartohen dhe fillohet me kurrikulat.

Sa i përket financimit të qendrave të arsimit dhe aftësisimit profesional, me mbështetje të Bankës Botërore dhe GIZ, është bërë analiza e kostos për disa profile (shëndetësi ekonomi, dhe disa profile teknike) të cilat do ta plotësojnë formulën e financimit e cila do të zhvillohet, bazuar në Planin Strategjik të Arsimit 2017-2021. Është bërë analiza e kostos së shpenzimeve për 2 vitet e fundit, për ti krahasuar me shpenzimet e tanishme. Në muajin korrik janë mbledhur të gjitha të dhënat për shpenzimet në shkollat profesionale nga thesari dhe janë duke u analizuar. Është duke e analizuar formula e financimit për arsim para universitar, në kuadër të së cilës analizë, parashihet edhe rishikimi i formulës për shkollat e arsimit profesional si pjesë e arsimit para universitar. Për këtë qëllim, është formuar edhe grupi pune me përfaqësues te Ministrisë së financave.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me mbështetje të projektit “EYE” ka pilotuar sistemin dual të mësimin në vend të punës në 4 shkolla profesionale në bashkëpunim me bizneset. Bazuar në këtë pilotim, është hartuar udhëzimi administrativ i cili e rregullon mësimin në vendin e punës. Bizneset të cilat kanë interes për profesione të caktuara dhe që ofrohen në shkollat kanë mundësi t’i qasen shkollës dhe të zbatojnë në bashkëpunim të ngushtë praktikën profesionale sipas nevojave të tyre.

Shtojcë: Pasqyrë e zbatimit të Planit të Veprimit

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
I. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit					
1.1	Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit që e bënë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion	1. Koncept-dokumenti mbi ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion	MD	Zbatuar	
		2. Miratimi i legjislacionit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion	MD	Në zbatim e sipër	MD akoma nuk e ka proceduar për miratim në Qeveri projekt-Kodin e Procedurës Penale
1.2	Ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlihdura, duke i harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët publik mund të kenë punësim apo emërim shtesë	1. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike duhet të ndryshohet, në harmoni me rekomandimet e BE-së: a. duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publik; b. duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarëve iu lejohet dhe iu ndalohe t'i kryejnë përderisa mbajnë postin; c. duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit; d. duhet të theksohen qartë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit; e. duhet të theksohen qartë procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.	MD	Zbatuar	
1.3	Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në financimin e partive politike: a. Realizimi i auditimeve të pavarura të financave të partive për vitet 2013-2015 b. Sigurimi i publikimit të raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj	1. Publikohen raportet financiare të partive politike dhe të ndërmerren veprim efikas për zbatim kundër atyre që nuk e përmbushin këtë	Kuvendi KQZ	Zbatuar	
		2. Të ofrohet financim adekuat për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të partive politike	Kuvendi	Zbatuar	
		3. Përzgjidhen auditorët e pavarur nëpërmjet thirrjes së hapur	Kuvendi	Zbatuar	
		4. Ndryshohet ligji për financimin e partive politike për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe zbatim dhe sanksione efikase, në bazë të konsultimeve të gjera publike	ZKM	Në zbatim e sipër	Kuvendi akoma nuk e ka miratuar projektligjin për financimin e partive politike.
1.4	Realizimi i rishikimit të pavarur të mekanizmeve të llogaridhënies së të gjitha institucioneve të pavarura, agjencive dhe organeve rregullatore, përcjelljen e rekomandimeve të tyre dhe miratimin e masave legjislative që përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e llogaridhënies së këtyre institucioneve	1. Kryhet një analizë cilësore e agjencive të pavarura dhe agjencive të pavarura rregullatore (analiza mbi rregulloren e marrëdhënies së punës, pagave, themelimin dhe organizimin e agjencive);	MAP	Zbatuar	
		2. Zotohet mbi zbatimin e rekomandimeve që dalin nga analiza cilësore	MAP ZKM Kuvendi	Zbatuar	
		3. Zhvillohet një koncept dokument për projektligjin mbi organizimin e administratës publike, shërbimin civil dhe pagat	MAP	Zbatuar	
		4. Miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.	MAP	Në zbatim e sipër	Kuvendi akoma nuk ka miratuar tri projektligjet.
1.5	Sigurimi se pakoja e planifikuar legjislative, që mbulon shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës shtetërore, përgatitet në mënyrë të	1. Hartohen koncept dokumente për projektligjet mbi: shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike	MAP	Zbatuar	
		2. Të miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike	MAP	Në zbatim e sipër	Kuvendi akoma nuk ka miratuar tri projektligjet.

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
	koordinuar në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi në bazë të koncepteve të dokumenteve të dakorduara në nivel qeveritar				
1.6	Sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparente, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike; zbatim i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit (AKK-DLK-3113/15).	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimi i legjislationit në fuqi për përzgjedhjen e institucioneve të pavarura për të siguruar procedurë të fuqishme, transparente dhe të bazuara në merita të përzgjedhjes së kandidatëve: <ul style="list-style-type: none"> Publikimi i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë Përfshirja e shoqërisë civile në komisionet përzgjedhëse, në bazë të një përzgjedhje transparente dhe të hapur të përfaqësuesve të shoqërisë civile; Fuqizimi dhe qartësimi i kriterëve minimale për kandidatët përmes përfshirjes së kriterëve të ngjashme me nenin 17 paragrafi 2 i ligjit mbi NP-të, për shembull, në ndryshimet në ligjin mbi konfliktin e interesit, duke i bërë kështu të aplikueshme në të gjitha agjencitë e pavarura dhe organet rregullative Qeveria zotohet të veprojë sipas rekomandimeve të lëshuara nga AKK më datë 15.02.2016 (AKK-DLK-3113/15) në lidhje me emërimet në 9 borde të NP-ve: <ul style="list-style-type: none"> Formulari/deklarata nën betim ndryshohet për të pasqyruar ligjin, për të gjitha emërimet e ardhshme ZKM-ja ndërmerr veprim sipas nenit 17.5 të ligjit (d.m.th 17.5 Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.) ZKM-ja ndërmerr veprime kundër zyrtarëve që kanë hartuar këtë formë/ deklaratë që nuk është në përputhje me ligjin. Sigurohet zbatimin e MM të nënshkruar ndërmjet Kuvendit, Qeverisë në njërin anë dhe Ambasadës së MB në Prishtinë në anën tjetër, për emërimet e anëtarëve të bordit të institucioneve të pavarura dhe agjencive. 	ZKM Kuvendi		
			ZKM	Zbatuar	
1.7	Zbatimi i vendimit të qeverisë të muajit mars 2016 mbi futjen e prokurimit të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të përmendura aty	<ol style="list-style-type: none"> Fillohet faza e dytë të pilot projektit të e-prokurimit Zbatohen ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike Trajnohen zyrtarët publik në nivel lokal Certifikohen zyrtarët publik në nivel qendror Certifikohen zyrtarët publik në nivel lokal Testohen modulet elektronike të prokurimit Hartohen udhëzimet operative mbi e-prokurimin. Qeveria duhet t'i ofrojë publikut të dhëna standarde të lexueshme nga makina në kohë reale të kontratave të prokurimit. 	KRPP MF KRPP KRPP KRPP KRPP KRPP	Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
1.8	Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara	KGJK do të realizojë një vlerësim të nevojave për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat Themelore Ekonomike. Vlerësimi do të përcaktojë kostot e buxhetit, si dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për reduktimin e rasteve të grumbulluara në Gjykatat Themelore Ekonomike.	KGJK	Zbatuar	
1.9	Vazhdimi i fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë nëpërmjet fuqizimit të kapacitetit të Prokurorisë Speciale që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë	1. Plotësim-ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimit të nivelit të lartë.	MD	Zbatuar	
		2. Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Prokurorisë Speciale për të kryer hetime financiare dhe për të konfiskuar pasuri.	ADK	Zbatuar	
Konkurreshmëria dhe klima e investimeve					
2.1	Promovimi i investimeve të huaja direkte a) Fuqizimi në mënyrë të konsiderueshme i kapaciteteve dhe përmirësimi i organizimit të portfolios së brendshme të Agjencisë së Kosovës për Investime për t'i mundësuar përmirësimin e performancës për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve b) Krijimi i një programi të shërbimit dhe kujdesit pasues për investitorët e mundshëm dhe mekanizmin e ankesës që ka kompetenca të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të tilla	a.1. Shqyrtim i thellë i fushëveprimit të përgjegjësive të KIESA, aktiviteteve të saj dhe përshkrimeve të punës	MTI	Zbatuar	
		a.2. Ristrukturimi i KIESA për t'i mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar	MTI	Në zbatim e sipër	Është hartuar draft rregullorja mbi organizimin e brendshëm të MTI-së por ende nuk është miratuar nga Qeveria
		a.3. Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve	MTI	Në zbatim e sipër	Nuk mund të realizohet pa realizimin e aktivitetit a.2.
		a.4. Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit	MTI	Në zbatim e sipër	Është përgatitur draft-vendimi por Qeveria ende nuk ka miratuar vendimin për themelimin e këtij bordi.
		b.1. Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët	MTI	Në zbatim e sipër	Nuk mund të realizohet pa realizimin e aktiviteteve a.1. dhe a.2.
2.2	Përmirësimi i mjedisit biznesor a. Fokusimi në përmirësimin e treguesve të raportit "Të të bërit biznes" të Bankës Botërore b. Harmonizoni rregullat me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar c. Reduktimi i barrës rregullative ndaj firmave, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licenca	a.1. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik lehtëson reformën e të bërit biznes duke u fokusuar në rezultatet dhe arritjet në takimet e saj të rregullta	MTI	Në zbatim e sipër	KKZhe është mbledhur për herë të fundit në dhjetor 2017. Është duke u shqyrtuar funksionalizimi më i mirë me mbështetje të EBRD.
		a.2. Përmirësimi i renditjes për zgjidhjen e paaftësisë paguese nëpërmjet zbatimit efikas të kornizës ligjore për falimentimin	MTI	Zbatuar	
		a.3. Shkurtimi i procedurave, kohës dhe kostos për marrjen e lejeve ndërtimore, përfshirë nëpërmjet ndryshimit të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore si dhe për Leje ndërtimore në K2 2017	MTI	Zbatuar	
		a.4. Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion	ZKM	Zbatuar	
		a.5. Numri biznesor i unifikuar	MF	Zbatuar	
	b.1. Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i hartuar	MF	Zbatuar		

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
	d. Prezantimi i ndryshimeve legjislative për të përmirësuar menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut e. Përafrimi i legjislacionit, përmirësimi i kapaciteteve të Organeve të Konkurrencës dhe Ndhimës Shtetërore dhe sigurohet që fillojnë zbatimin e mandatit të tyre	b.2. Konsultimet publike me Shoqërinë Civile dhe partnerët zhvillimorë, të mbajtura	MF	Zbatuar	
		b.3. Ligji, i miratuar nga Kuvendi	MF	Zbatuar	
		c.1. Ligji i ri për shoqëritë tregtare është konsultuar me shoqërinë civile dhe akterët relevantë dhe është miratuar	MTI	Zbatuar	
		c.2. Legjislacioni sekondar i ligjit për shoqëritë tregtare, i miratuar	MTI	Zbatuar	
		c.3. Regjistri Qendror Online për Licenca dhe Leje është përditësuar më tej, përfshirë tarifatat dhe procedurat e kërkuara për marrjen e lejeve dhe ngarkimi i formularëve të aplikimit në bazën e të dhënave	ZKM	Zbatuar	
		d.1. Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar për të reformuar aspektet kryesore procedurale, institucionale dhe funksionale	MTI	Në zbatim e sipër	Ende nuk është hartuar ligji
		d.2. Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant, të mbajtura	MTI	Në zbatim e sipër	Nuk mund të realizohet para aktivitetit d.1.
		d.3. Ligji për inspektimet e përgjithshme, i miratuar	MTI	Në zbatim e sipër	Nuk mund të realizohet para aktiviteteve d.1. dhe d.2.
		e.1. Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për realizimin e hetimeve	AKK	Në zbatim e sipër	AKK akoma nuk ka përfunduar rekrutimin e 3 zyrtarëve të planifikuar.
		e.2. Autoriteti i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatis një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun në Kosovë, me rekomandimet e duhura	AKK	Zbatuar	
		e.3. Përafrohet dhe ndryshohet ligji për ndihmë shtetërore dhe përafrohet legjislacioni sekondar	MF	Në zbatim e sipër	Nuk është miratuar i gjithë legjislacioni sekondar (për shembull Rregullorja për funksionimin e Komisionit të ndihmës Shtetërore). Është miratuar rregulloja për procedurat e njoftimit.
		e.4. Siguroni pavarësinë operative dhe kapacitete të mjaftueshme për të përmirësuar efikasitetin e kontrollit të tij në ndihmën shtetërore	MF	Zbatuar	
		2.3	Zbatimi në mënyrë sistematike i strategjisë dhe planit të veprimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale	1. Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut, duke u fokusuar në sektorët më të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale, krimeve financiare, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit (duke mbuluar aspektin gjinor) 2. Rishikohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut 3. Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimin në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit, të sigurohen të drejtat e punonjësve dhe të sigurohet konkurrencë e drejtë në fushën e biznesit 4. Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet (me ndihmën e projektit IPA 2015) 5. Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara **	MF MF MF MF MF

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
2.4	Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve a) Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth 'Aktit të Bizneseve të Vogla' b) Miratimi i masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë c) Prezantimi i programeve dhe instrumenteve të eksportit për ndihmuar që NMV-të të integrohen në zinxhirët global të vlerës, me qëllim të mbështetjes së ndërkombëtarizimit të tyre d) Miratimi i masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar me qëllim të rritjes së qasjes së NMV-ve në financa	a.1. Struktura e koordinimit të ABV është themeluar, përfshirë pikat e kontaktit për secilën ministri	MTI	Zbatuar	
		a.2. KIESA fuqizon përpjekjet e gjera koordinuese të qeverisë për zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi i Aktit të Bizneseve të Vogla, përfshirë nëpërmjet takimeve të rregullta koordinuese	MTI	Zbatuar	
		b.1. Avancimi dhe përditësimi i rregullt i ueb-faqes, për tu përdorur si një platformë informuese online për bizneset, përfshirë këtu dhe infrastrukturën e cilësisë	MTI	Zbatuar	
		b.2. 10 punëtori, të organizuara me qëllim të informimit të bizneseve sa i përket infrastrukturës së cilësisë dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni specifik vertikal, përfshirë këtu dhe promovimin e ueb-faqes si platformë informuese	MTI	Zbatuar	
		b.3. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore në fushën e infrastrukturës së cilësisë, duke përfshirë mënyrën nëpërmjet trajnimit të stafit (organizimi i 30 moduleve të trajnimit) dhe organeve të vlerësimit të konformitetit	MTI	Zbatuar	
		b.4. 1,500 standarde, të miratuara, me fokus në fushat e harmonizuara	MTI	Zbatuar	
		b.5. Laboratorët metrologjikë ekzistues, të furnizuar me pajisje	MTI	Zbatuar	
		b.6. Ligji mbi shërbime, i hartuar dhe konsultuar me shoqërinë civile dhe akterë të tjerë relevantë	MTI	Zbatuar	
		b.7. Ligji mbi shërbime, i miratuar (transpozimi i pjesës së Direktivës 123/EC mbi shërbime)	MTI	Zbatuar	
		b.8. Pika e vetme e kontaktit për shërbime, e themeluar dhe funksionale	MTI	Zbatuar	
		c.1. Bizneset, të mbështetura për të rritur konformitetin e produktit të tyre (certifikimi i produktit) dhe ndërkombëtarizimin e tyre	MTI	Zbatuar	
		c.2. Kosova i bashkohet Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve	MTI	Në zbatim e sipër	Aktualisht janë duke u diskutuar me KE-në procedurat për anëtarësim në këtë rrjet.
		c.3. Kosova merr pjesë në programin COSME për mbështetjen e NVM-ve në lehtësimin e qasjes në financa, përmirësimin e qasjes në tregje dhe rritjes së konkurrencës dhe kulturës ndërmarrëse	MTI	Zbatuar	
		d.1 Miratimi i ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare	MF	Në zbatim e sipër	Kuvendi akoma nuk e ka miratuar këtë projektligj.
		d.2. Futja në funksion e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK)	MTI	Zbatuar	
2.5	Zhvillimi i mëtejshëm i disa statistikave sektoriale, kyçe për politikë bërje në fushën e llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, statistikave të energjisë dhe atyre sociale	1. Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të llogarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë me metodologjinë e ESA 2010	ASK	Zbatuar	
		2. Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuara (vëllimit të prodhimit industrial dhe indekset e çmimeve)	ASK	Zbatuar	
		3. Rezultatet nga statistikave të Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar	ASK	Zbatuar	
		4. Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, e kryer	ASK	Zbatuar	
		5. Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare	ASK	Zbatuar	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
2.6	Përmirësimi i lidhjes rajonale a) Zbatimi i projekteve të investimeve publike individuale me prioritet, në veçanti duke miratuar raportin e rishikuar të zbatimit të klauzolës së investimeve, në bazë të "Listës prioritare të projekteve infrastrukturore" b) Zbatimi i të gjitha 'masave të buta' të mbetura të lidhjes, dhe reformat përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë	a.1. Qeveria miraton raportin e rishikuar mbi zbatim, për klauzolën e investimeve	ASK	Zbatuar	
		a.2. Numri i marrëveshjeve financiare, i ratifikuar në Kuvend në lidhje me projektet brenda Klauzolës së Investimeve, e miratuar nga KKI dhe Qeveria	MF	Zbatuar	
		<u>Energjia</u>	MZHE	Zbatuar	
		6.b.i. Legjislacioni dytësor që rrjedh nga ai primar, i miratuar			
		6.b.ii Çmimet e parregulluara të energjisë:	MZHE	Zbatuar	
		1. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së), e ndryshuar dhe miratuar;			
		2. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së), e miratuar;			
		3. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), e miratuar;			
		6.b.iii. Tregu i përbashkët energjetik me Shqipërinë, i krijuar	MZHE	Në zbatim e sipër	Bursa energjetike akoma nuk është krijuar; dhe është e ndërlidhur me mos zbatimin e marrëveshjes së energjisë nga pala serbe
		6.b.iv. Tregu i aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës), i krijuar	KOSTT	Në zbatim e sipër	Nuk mund të realizohet para veprimit 6.b.iii dhe është e ndërlidhur me mos zbatimin e marrëveshjes së energjisë nga pala serbe
6.b.v.Furnizuesit e rinj të energjisë elektrike, të krijuar	ZRrE	Zbatuar			
6.b.vi.Marrëveshja ndërmjet KOSTT-EMS, e zbatuar	KOSTT	Në zbatim e sipër	Në zbatim e sipër për shkak të moszbatimit nga ana e Serbisë të marrëveshjes për energji. Në zbatim e sipër		
6.b.vii. Kodi i rregullatit të KOSTT-it, i harmonizuar me atë të ENTSO-E.	KOSTT	Në zbatim e sipër	Në zbatim e sipër për shkak të moszbatimit nga ana e Serbisë të marrëveshjes për energji.		
<u>Transporti</u>	MI	Zbatuar			
6.b.1.Hapja e tregut të transportit					
6.b.1.1. Zbatimi i strategjisë së reformës hekurudhore	MI	Në zbatim e sipër	Ky formulim është prioritet dhe jo veprim i cili mund të përmbushet për 2-3 vite. Veprimet në Transport janë vendosë me insistim të Komisionit Evropian duke marrë për bazë agjendën e konektivitetit. Kjo vlen edhe për veprimet e radhës. Ajo çka mbetet të adresohet në nivel Ministrash (MF, MZHE, MI) është nëse ka vullnet dhe dakordancë për		

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
					nënshkrimin e marrëveshjes financiare pesëvjeçare me INFRAKOS.
		6.b.2.Krijimi i një sistemi konkurrues, të besueshëm dhe të sigurt sa i përket transportit	MI	Në zbatim e sipër	Akoma nuk është finalizuar projektligji për plotësim-ndryshimin e ligjit për rrugët.
		6.b.2.1 Përmirësimi i sigurisë në rrugë. Synimi i uljes së objekteve me 20% krahasuar me vitin e referuar 2014	MI	Në zbatim e sipër	Nuk është arritur caku prej 20%.
		6.b.2.2. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit	MTI	Në zbatim e sipër	Protokollu V është për shqyrtim në Presidencë.
		6.b.2.3. Vendosja e sistemit inteligjent të transportit (SIT) në Rrjetin Kryesor	MI	Në zbatim e sipër	Akoma nuk është përfunduar analiza dhe rekomandimet për krijimin e SIT.
		6.b.2.4. Krijimi i sistemit funksionues të mirëmbajtjes, duke siguruar që asnjë seksion të mos ketë gjendje të keqe/shumë të keqe	MI	Në zbatim e sipër	Duhet bërë vlerësimi i gjendjes aktuale të rrjetit rrugorë dhe hekurudhorë dhe të krijohet një bazë e shënimeve e cila do të përdoret për vlerësimin e gjendjes dhe përgatitjen e planit të veprimit për periudhën 2019-2023 për Mirëmbajtjen e Rrjetit Bërthamë dhe Gjithëpërfshirës të SEETO's (nivel rajonal)
		6.b.3. Rritja e efektivitetit të Procedurave të kalimit të kufirit	MPB	Zbatuar	
		6.b.3.1. Marrëveshjet efektive të kalimit kufitar	MPB	Në zbatim e sipër	Tri nën-protokollet me Maqedoninë akoma nuk janë nënshkruar.
		6.b.3.2. Zbatimi i strategjisë për Menaxhimin e integruar të kufirit (MIK)	MPB	Në zbatim e sipër	Akoma nuk ka përfunduar ndërtimi i pikëkalimeve të përbashkëta me Serbinë.
2.7	2.7. Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026	7. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2016-2025 e cila është në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të BE-së	MZHE	Zbatuar	
	a. Vendosja për modalitetet e pronësisë për Kosova B dhe për investimet e reja në gjenerimin e energjisë, dhe dekomisionimi i Kosova A	7.a.i. Vendimet për modalitetet e pronësisë së Kosova B, të marra	MZHE	Zbatuar	
		7.a.ii. Investimet e reja në gjenerimin e energjisë (të gjitha burimet)	MZHE	Zbatuar	
		7.a.iii. Afati i fundit për dekomisionimin e Kosovës A, të jetë fiks	MZHE	Zbatuar	
	b. Miratimi i Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtërishme	7.b.i. Raporti i dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për BRE, i përgatitur	MZHE MMPH	Zbatuar	
	c. Vlerësimi i modaliteteve më të mira për krijimin e mekanizmit për	7.b.ii. Miratimi i planit për burimet e ripërtërishme, i përditësuar, duke përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova po arrin 25% të objektivave të energjisë së ripërtërishme në vitin 2020	MZHE MMPH	Në zbatim e sipër	Plani i Veprimit për BRE akoma nuk është miratuar.
		7.c.i. Misioni i TAIEX për të vlerësuar modalitetet e mekanizmit të financimit për eficientësinë e energjisë dhe masat e marra mjedisore	MZHE MMPH	Zbatuar	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
	financimin e efijencës së energjisë dhe masat mjedisore në sektorin publik dhe atë të rezidencial, dhe nxitja e përdorimit të plotë të iniciativave ekzistuese siç është Programi Rajonal për Efijencë	7.c.ii.Vlerësimi dhe marrja e vendimeve për modalitetet e mekanizmit të financimit për të mbështetur investimet në efijencën e energjisë dhe mjedisit	MZHE MMPH	Zbatuar	
		7.c.iii. Miratimi i planit të veprimit 2016-2018 mbi efijencën e energjisë	MZHE MMPH	Zbatuar	
		7.c.iv. Miratimi i ligjit mbi performancën e energjisë në ndërtesa	MZHE MMPH	Zbatuar	
		7.c.v.Miratimi i legjislacionit sekondar, që transponon Direktivën 2010/31/EU nëpërmjet a) Rregullores për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja të banimit, ndërtesat nën renovim dhe llojet e tjera të ndërtesave të banimit, b) Rregullores për certifikatën e performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ndërtesave të tjera c) Rregullores për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve për kondicionimin e ajrit;	1MZHE MMPH	Në zbatim e sipër	Akoma nuk janë miratuar edhe dy rregullore; veprimi konsiderohet në zbatim e sipër.
Punësimi dhe arsimit					
3.1	Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015- 2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë	1. Strategjia Sektoriale është hartuar dhe konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve 2. Strategjia Sektoriale dhe Plani i saj i Veprimit, të miratuara 3. Buxheti për zbatimin e strategjisë është ndarë	MPMS MPMS MPMS	Zbatuar Zbatuar Zbatuar	
3.2	Përmirësimi i mundësive të punësimit a) Përgatitja e planit të veprimit për trajtimin e papunësisë së të rinjve bazuar në vlerësimin e sfidave dhe duke u përqendruar në përmirësimin e rezultateve arsimore dhe mbështetjen e kalimit nga shkolla në punë b) Ndërmarrja e masave për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës	a.1 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është hartuar a.2 Draft Plani i veprimit është konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve a.3 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është miratuar b.1 Rritet asistenca e pranuar nga gratë nga shërbimi i punësimit b.2 Draft analiza e pengesave në punësimin e femrave është bërë në konsultime me akterët relevantë b.3 Përdorimi i analizës për zhvillimin e masave të duhura për përmirësimin e papunësisë së grave	MPMS MPMS MPMS MPMS MPMS MPMS	Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar Zbatuar	
3.3	Sigurimi i zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit, në veçanti nëpërmjet funksionalizimit të agjencisë për punësim dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që është në gjendje të iniciojë masat aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme	1. Realizimi i një vlerësim të nevojave të tregut të punës (përfshirë mbi AAP) 2. Përzgjedhja e Drejtorit të Agjencisë së Punësimit dhe Bordit Këshillues është përfunduar dhe rregulloret e punës për Agjencinë e Punësimit janë miratuar 3. Masat aktive të tregut të punës janë zbatuar nga Agjencia e Punësimit (thirrjet për aplikime janë lansuar, mbështetja financiare është dhënë sipas rezultateve të thirrjeve)	MPMS MPMS MPMS	Zbatuar Zbatuar Zbatuar	
3.4	Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit	1. Projektligji i rishikuar mbi arsimin e lartë, i miratuar 2. Projektligji mbi profesionet e rregulluara në Kosovë, është miratuar	MASHt MASHt	Në zbatim e sipër Zbatuar	Është hartuar draft-ligji por ende nuk është miratuar në Qeveri.

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
		3. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 është miratuar nga Qeveria dhe është ndarë buxheti i nevojshëm për të siguruar zbatimin e tij	MASHT	Në zbatim e sipër	Buxheti i nevojshëm për mbulimin e hendekut financiar nuk është siguruar.
3.5	Përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet: a. Krijtes së vijueshmërisë së arsimit parashkollor b. Realizimi i vlerësimit/vlerësimit të jashtëm dhe përshpejtimi i zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë me tekstet e reja shkollore në arsimin para-universitar c. Krijimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe në shërbim të mësimdhënësve. d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë IAL-të mbi rëndësinë e kurrikulave mësimore, identifikimi i mangësive në shkathtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvojë në punë praktike për studentët	a.1 Numri i objekteve publike për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është rritur	MASHT	Në zbatim e sipër	Janë 13 qerdhe publike në ndërtim e sipër.
		b.1. Kurrikula bërthamë për arsimin parashkollor është zhvilluar dhe ka filluar faza e saj e pilotimit	MASHT	Në zbatim e sipër	Është hartuar por nuk është miratuar ende.
		b.2 Korniza e Kurrikulës Bërthamë e Arsimit Para-universitar (i vitit 2011 dhe 2012) është shqyrtuar dhe miratuar dhe rezultatet e të nxëniet për lëndët dhe klasat është janë zhvilluar në shkolla	MASHT	Zbatuar	
		b.3 Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe syllabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe miratuar me zbatimin të mëposhëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018	MASHT	Në zbatim e sipër	Programet lëndore per disa klase nuk janë zhvilluar ende (klasat 4,5), ndërsa per disa janë vetëm ne faze pilotimi (klasat 3,8,12)
		c.1. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë të zhvilluara përmes emërimit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe krijimit të sistemit efikas për vlerësimin e performancës në shkolla	MASHT	Në zbatim e sipër	Akoma nuk është përfunduar vlerësimi i jashtëm i shkollave të pazgjedhura në shtatë (7) rajonet e vendit.
		c.2. Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim është themeluar dhe është plotësisht funksionale	MASHT	Në zbatim e sipër	Kompetencat e Agjencisë i janë dhënë një Divizioni në mungesë të mjeteve për ta krijuar agjencinë.
		c.3. Projektligji i rishikuar mbi inspektoratin e arsimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi dhe inspektorët kanë filluar aktivitetet e tyre, me inspektorë dhe kapacitete të mjaftueshme	MASHT	Zbatuar	
		d.1. Krijimi dhe funksionalizimi i Këshillave Industriale	MASHT	Zbatuar	
		d.2. Shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit	MASHT	Në zbatim e sipër	Nuk ka zhvillime rreth shqyrtimit të politikave të regjistrimit
		e.1 Projekt propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në universitete që këshillojnë IAL-të, është prezantuar	MASHT	Zbatuar	
		e.2 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitete që këshillojnë IAL-të shkon në konsultime publike	MASHT	Zbatuar	
		e.3 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitetet që këshillojnë IAL-të është miratuar dhe fillon zbatimin	MASHT	Zbatuar	
3.6	Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë	a.1 Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (së bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë	MPMS / APPK	Zbatuar	
		a.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësimi profesional përmes harmonizimit të AAP me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës	MASHT	Në zbatim e sipër	Janë shqyrtuar disa profile në mënyrë individuale por nuk ka pasur një shqyrtim të përgjithshëm në nivel vendi që do të harmonizonte këtë me kërkesat e tregut.
		a.3 Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit	MASHT	Në zbatim e sipër	Nuk janë miratuar kurrikulat dhe nuk është bërë pilotimi i tyre.

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Institucionet përgjegjëse	Gjendja	Shpjegime
		a.4 Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së	MASHT	Në zbatim e sipër	Akoma nuk ka përfunduar rishikimi i formulës së financimit të qendrave të AAP-së që do të siguronte financimin e duhur.
		b.1 Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore	MASHT	Në zbatim e sipër	Është pilotuar sistemi dual i të mësuarit praktik, por nuk është përfshirë në të gjitha programet e AAP si pjesë integrale.